



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Tretë Specializime Afatgjata në:
“Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Grupi Vlerësimit të Jashtëm:


Prof.Dr. Lul Raka

Prof. Asoc. Gazment Koduzi

Shkurt /2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Specializime Afatgjata në "Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Kirurgjikale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Specializime Afatgjatë në: "Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 664, datë 28.12.2017
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i tretë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	300ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Itالية
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata"
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 8 (tetë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023: 28 PAE/2 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2019-2020: 6 studentë; Viti akademik 2020-2021: 4 studentë; Viti akademik 2021-2022: 2 studentë; Viti akademik 2022-2023: 2 studentë; Viti akademik 2023-2024: 1 student;
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 567, datë 27.08.2004 si Shkolla e Lartë Universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë", riorganizuar me VKm Nr. 670 datë 28.9.2011, në Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". UKZKM aktualisht përbëhet nga 4 (katër) fakultete:


1. Fakulteti i Farmacisë;
2. Fakulteti i Mjekësisë;
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara;
4. Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale;

Programi i studimit specializim afatgjatë në: "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive" është një program studimi që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kirurgjikale, Fakulteti i Mjekësisë. Programi është licensuar sipas Urdhërit të MASR nr. 664 datë 28.12.2017 bazuar në VBA Nr.110 datë 10.11.2017 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi specializim afatgjatë në "Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive" të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Ky program studimi përmban 300 ECTS dhe është i organizuar në 5 (pesë) vite akademike (10 semestra), dhe ofrohet në gjuhën italiane.

Në përfundim të këtij program studimi lëshohet diplomë Specializim afatgjatë në: "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive", referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Njësia bazë kryesore ku ofrohet programi i studimit është departamenti i Shkencave Kirurgjikale, si dhe Njësia kryesore Fakulteti i Mjekësisë që është përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e programit duke kontribuar përmes katër departamenteve dhe strukturat e tjera, duke dhënë kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit. Në këtë fushë studimi Fakulteti ofron dhe programin Msc Mjekësi e përgjithshme.

Ky program ka si objektiv të ofrojë personel të trainuar në anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive në të gjitha nivelet e kujdesit spitalor. Ky program kontribuon në plotësimin e nevojave të tregut në nivel kombëtar por edhe rajonal.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTË M

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit të ciklit të tretë specializim afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive" ofruar nga Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të mirë". Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të tretë Specializim afatgjatë në mjekësi, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. (ascal.al) Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht;


Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL. Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimëve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof.Dr. Lul Raka dhe Prof.As. Gazmend Koduzi. Koordinator Teknik e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Majlinda Demireli.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UKZKM e zhvilluar në datat 13-14 Nëntor 2024. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

- Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e FM. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm studentëve dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu GVJ vlerëson edhe mbështetjen e ASCAL në këtë proces të parë të realizuar për këtë program studimi. Nga ana tjetër shprehim bindjen se ky akreditim i parë, gjetjet dhe konstatimet në këtë raport, do t'i vlejë institucionit të përmirësojë më tej programin e studimit.

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 17.01.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 34 Prot, datë 17.01.2025. Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" përcjell në ASCAL më datë 05.02.2025, me anë të shkresës me Nr. 374/4 Prot, datë 04.02.2025, "*Kshim përgjigje shkresës me nr 34. Prot, datë 17.01.2025*", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti marr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Specializime Afatgjatë
"Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive"

I KUADRI PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË

Standardi L1	
Programi i studimit i ciklit të tretë Specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë ofrohet nga institucione të arsimit të lartë që përmbushin kriteret ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë ofrohet nga institucione me statusin universitet, i akredituar në Republikën e Shqipërisë.	Programi i studimit të specializimit afatgjatë në: Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive, ofrohet nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", institucion jopublik i arsimit të lartë, licensuar me VKM nr. 567 datë 27.08.2004, dhe riorganizuar me VKM nr. 670 datë 28.09.2011. UNIZKM është akredituar me Urdhër Nr. 375, datë 18.10.2007, Urdhër nr. 136, datë 25.03.2016 dhe Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 112, datë 15.12.2017, për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare me afat vlefshmërie, deri në 14.12.2023. <i>Evidencë nr.1: VKM nr. 567 datë 27.08.2004;</i> <i>Evidencë nr.2: VKM nr. 670 datë 28.09.2011;</i> <i>Evidencë nr.9: Vendimi Nr. 112, datë 15.12.2017 i Bordit të Akreditimit;</i>
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë që ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit të jenë të akredituara në vendin e origjinës.	Ky program është hapur me Urdhër nr. 664, datë 28.12.2017 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i cili realizohet me 300 kredite, me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 5 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet "diplomë specializimi" në "Anestezi, reanimacion dhe terapi intensive". Ky program ofrohet nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", në bashkëpunim me Universitetin e Romës (Tor Vergata), akredituar nga Agenzia Nazionale di valutazione del sistema universitario e della ricerca, Itali. <i>Evidencë nr. 4: Urdhër i Ministrit nr. 664, datë 28.12.2017 "Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë, programe specializimi afatgjatë, në Universitetin</i>

	<i>Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Evidencë nr.10: Linku i akreditimit të Universitetit Tor Vergata, Romë.</i>
Kriteri 3: Programi i specializimit afatgjatë hartohet nga njësitë bazë përgjegjëse/shërbimet përgjegjëse të institucionit nëpërmjet procedurave të brendshme transparente dhe miratohet në përputhje me statutin, rregulloren dhe aktet e tjera organizative të institucionit.	Programi i specializimit afatgjatë në Anestezilogji, Reanimacion dhe Treapi intensive është i përgatitur nga Departamenti i Shkencave Kirurgjikale, dhe miratuar nga Senati, bazuar në Statutin e Universitetit ZKM aprovuar me VKM nr.567 datë 27.08.2004. Referuar <i>"Marrëveshjes kuadër për bashkëpunim në zhvillimin e aktiviteteve formuese në fushën e mjeksisë dhe atë shëndetësore të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", me nr. 0006800 prot, datë 08.02.2023, UNIZKM dhe Universitetit "Tor Vergata", angazhohen në mundësinë e bashkëpunimit për realizimin e programeve Bachelor, Master të nivelit të parë dhe të dytë, si dhe shkolla të specializimit dhe programe doktorate, me qëllim lëshimin e titujve të përbashkët universitar, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri dhe Itali.</i> <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi në UKZKM 2023;</i> <i>Evidencë nr 48: Procesverbali i Senatit Akademik;</i> <i>Evidence 5 - Marrëveshje Kuadër për bashkëpunimin midis UKZKM me Universitetin e studimeve në Romë Tor Vergata;</i>
Kriteri 4: Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të akredituar nga institucioni shtetëror përgjegjës për akreditimin e institucioneve shëndetësore. Institucionet e arsimit të lartë duhet të kenë zhvilluar dhe akredituar/riakredituar programet e integruara të ciklit të dytë në fushën e	Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në universitetin ZKM i akredituar nga ASCAL me VBA Nr. 112, datë 15.12.2017 për një periudhë 6 (gjashtë) vjecare. Ndërkohë, praktikat klinike kryhen në institucione spitalore publike dhe private, si QSUT "Nënë Tereza", që është i akredituar nga institucionet përkatëse. Bazuar në VKM nr. 567 datë 27.08.2004, "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike "Zoja e Këshillit të Mirë" institucioni ka hapur program 6 vjecar në Mjeksi të Përgjithshme, dhe specializime afatgjatë 5 vjecare. <i>Evidencë nr.9: Vendimi Nr. 112, datë 15.12.2017 i Bordit të Akreditimit,</i>

mjekësisë në momentin e ofrimit të një programi të ciklit të tretë.	<i>Evidencë nr.4: Urdhëri i Ministrit nr. 664 datë 29.12.2017 "Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të tretë specializim";</i> <i>Evidencë nr.11: Linku institucioneve spitalore të akredituara;</i> <i>Evidencë nr.14: Marrëveshje midis UNIZKM dhe QSUT;</i>			
Kriteri 5: Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të departamenteve/shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës.	Programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive" kryhet me kohë të plotë nga studentët e regjistruar në këtë program. Aktiviteti teorik dhe praktik zhvillohen në ambjentet e Fakultetit të Mjekësisë të UNIZKM, QSUT, spitali rajonal Durrës, si dhe spitali i Universitetit Tor Vergata, struktura shëndetësore në Mantova, nën mbikqyrjen e udhëheqësit klinik, udhëheqësit akademik dhe Drejtorit të shkollës së Specializimit. Cdo aktivitet pjesë e programit të studimit të specializimit bazohet në Rregulloren e programit të specializimit. <i>Evidencë nr.14: Marrëveshje midis UNIZKM dhe QSUT, Evidencë nr.Marrëveshje midis UNIZKM dhe Spitalit Rajonal Durrës;</i> <i>Evidencë nr.19: Marrëveshje midis UNIZKM dhe struktura shëndetësore Mantova;</i> <i>Evidencë nr.16: Marrëveshje midis UNIZKM dhe Spitalit Amerikan;</i> <i>Evidencë nr.41: Rregullore e programit të specializimit afatgjatë në Mjeksi;</i>			
Konkluzione	Programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive", ofrohet nga UNIZKM, i cili është akredituar nga autoritetet përkatëse, është dizenuar dhe aprovuar sipas rregulloreve të Universitetit. Universiteti ofron ciklin e tretë të programit të specializimit pasi ka ofruar programe të ciklit të parë dhe të dytë, akredituar nga autoritetet përkatëse. Programi i specializimit zhvillohet në ambjentet e UNIZKM dhe spitalet, sipas rregullores së specializimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi L2				
Programi i studimit specializim afatgjatë në mjekësi ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1: Programi i studimit specializim afatgjatë hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit.	Programi i studimit specializim afatgjatë në "Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive", është hartuar dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të Statutit të UNIZKM, Neni 9: programi i specializimit është në përputhje me kornizën ligjore për edukimin e lartë dhe strategjinë e zhvillimit, ndjek misionin e saj dhe kryen gjithë aktivitetet brenda sisemit universitar kombëtar. Ky program specializimi është në përputhje me misionin, principet dhe vlerat, dhe strategjinë për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit në bashkëpunim me palët e treta, dhe prigrane të kërkimit shkencor ndërkombëtar. <i>Evidencë nr.23: Statuti i UNIZKM</i>			
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë ka të përcaktuara qartë emërtimin, organizimin, strukturën, përmbajtjen, qëllimin dhe objektivat e tij, të harmonizuara me ato të institucionit/institucioneve ofrues, në përputhje dhe me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve	Bazuar në Urdhërin nr. 664 datë 28.12.2017, të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, programi i specializimit afatgjatë ka të përcaktuara qartë emërtimin në "Anestezi, reanimacion dhe terapi intensive", i cili është i organizuar në 5 vite akademike, me 300 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, duke i përkuar nivelit të 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Qëllimi dhe objektivat specializimit afatgjatë janë të mirëpërcaktuara në "Rregulloren e specializimit" që janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e UNIZKM dhe kornizës ligjore të Arsimit të Lartë. <i>Evidencë nr.3: VKA dt. 10.11.2017;</i> <i>Evidencë nr.41: Rregullore e programit të specializimeve afatgjatë në Mjekësi;</i>			
Konkluzione	Programi i studimit Specializues afatgjatë në "Anestezi, reanimacion dhe terapi intensive" ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, qëllimi dhe objektivat të përshkruara në Statutin e UNIZK që është në përputhje me kornizën ligjore të Arsimit të Lartë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi L3	
Programi i studimit specializim afatgjatë synon të plotësojë nevojat aktuale që ka vendi për specialistë në fushën e mjekësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.	Bazuar në studimin e tregut të këtij program studimi, në Shqipëri janë të regjistruar në Urdhërin e Mjekut 175 specialistë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", shifër që përkon me një dendësi prej 6.11 specialistësh të kësaj fushe për 100 000 banorë, dhe nga ana tjetër ka rritje të ndërhyrjeve apo procedurave kirurgjikale që kanë nevojë për asistimin nga mjekë anestezistë. Duke marrë në konsideratë faktet si më sipër, cikli i tretë i specializimit në ARTI ka si qëllim që të ndihmojë në plotësimin e nevojave të tregur shëndetësor shqiptar për anestezistë. <i>Evidencë nr. 345: Studimi i tregut për Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive</i>
Kriteri 2: Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj).	Bazuar në Bazuar në Urdhërin nr. 664 datë 28.12.2017, të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Universitetit Katolik Zoja e Këshilit të Mirë, numri i studentëve të parashikuar për vitin akademik janë 4 (katër) student. Ky numër është vendosur bazuar në kapacitetet trainuese të strukturave shëndetësore me të cilat UNIZKM ka marrëveshje dhe të angazhuar në programin e specializimit specifik. Nga ana tjetër, çdo vit Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Shëndetësisë dhe çështjeve sociale aprovojnë numrin e studentëve që do të futen në prgramet e specializimit bazuar në nevojat e sistemit shendetësor. <i>Evidencë nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Univesrsitetit Katolik Zoja e Këshilit të Mirë"</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Specializues afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ka si synim që të ndihmojë në plotësimin e nevojave aktuale dhe të së ardhmes të vendit për anestezistë, bazuar në numrin e ulët të anestezistëve në</i>

	vend, numrin në rrëzje të procedurave kirurgjikale që kanë nevojë për asistencë të anestezistit, si dhe kapacitetet trainuese të infrastrukturës edukuese.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi L4


Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të miratuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë.	Programi i studimit Specializues afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ofruar nga UNIZKM, sipas planit mësimor përfshin training teorik dhe praktik në lëndë disiplina të përgjithshme, klinike, urgjencë dhe ndihmë e parë, dhe disiplina specifike anestezi, reanimacion dhe terapi intensive. Sipas "Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata" Neni 7, të paktën 80% e krediteve (ECTS) totale të aktivitete klinike profesionalizuese, i takojnë specializimit përkatës, ndërsa 20% i takojnë studimeve teorike. Si aktivitetet teorike dhe ato praktike kryhen në institucione të akredituara nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe çështjeve sociale, Ministria e Arsimit e Italisë. UNIZKM, QSUT "Nënë Tereza", Spitali American, Spitali Rajonal Durrës, struktura spitalore në Itali (Tor Vergata, Mantova, M.G. Vaninni). <i>Evidencë nr 12: Rregullore e specializimit afatgjatë në M.jekësi;</i> <i>Evidencë nr 10: Link i institucioneve arsimore të akredituara nga ANVUR;</i> <i>Evidencë nr 11: Link institucionet shëndetësore spitalore të akredituara nga MSH;</i>
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë akademike, klinike/diagnostikuese të departamenteve dhe/ose	Bazuar në Urdhërin nr. 664 datë 28.12.2017, programi i studimit ofrohet me kohë të plotë, zgjat 5 (pesë) vite akademike, dhe në fund të specializimit studentët duhet të marrin 300 ECTS. Sipas "Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata" Neni 7, të paktën 80% e krediteve (ECTS) totale të aktivitete klinike profesionalizuese, ti takojnë


shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me rregulloren e programeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.	specializimit përkatës, ndërsa 20% ti takojnë studimeve teorike.			
	Sipas rregullores së programeve të specializimit afatgjatë, aktivitetet akademike dhe klinike zhvillohen në ambjentet e Departamenti të Shkencave Kirurgjikale, Fakulteti i Mjekësisë, dhe strukturat spitalore që kanë marrëveshje bashkëpunimi për forimin e programit të specializimit.			
	Evidencë nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, programi studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Universitetit Katolik Zoja e Këshilit të Mirë";			
	Evidencë nr 12: Rregullore e specializimit afatgjatë në Mjekësi;			
Konkluzione	Programi i studimit është dizajnuar bazuar në kërkesat ligjore, duke përfshirë edukim terik dhe praktik. Sipas "Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata" Neni 7, të paktën 80% e krediteve (ECTS) totale të aktiviteteve klinike profesionalizuese, i takojnë specializimit përkatës, ndërsa 20% i takojnë studimeve teorike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Programi i studimit i ciklit të tretë specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë synon të plotësojë nevojat që ka vendi për specialistë në fushën e mjekësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Për hartimin e programit të specializimit afatgjatë, njësi bazë përgjegjëse/shërbimi përgjegjës, kryen studime dhe analiza mbi situatën, zhvillimet, nevojat, prioritetet në fushën e përgjithshme dhe specifike të programit dhe/ose të politikave shtetërore të	Zyra e Këshillimit e Karrierës në UNIZKM ka kryer studim të tregut në fushën e kujdesit shëndetësor, përpara se të hapet programi i studimit të specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive". Studimi ka marrë në konsideratë numrin e mjekëve në Shqipëri dhe shpërndarjen e tyre sipas qarqeve, si dhe trendin e largimit të mjekëve nga vendi. Sipas studimit të tregut, në Shqipëri janë 175 mjekë specialistë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", shifër që përkon me një dendësi prej 6.11 specialistësh të kësaj fushe për 100 000 banorë, dhe nga tabela

zhvillimit të fushës së shëndetësisë, të cilat bëhen pjesë e projekt propozimit përpara hapjes së programit.	rezulton se pjesa më e madhe e specialistëve janë të përqendruar në Tiranë. <i>Evidencë nr 34: Studimi i tregut në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive";</i>
Kriteri 2: Programi i specializimit afatgjatë ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e specialistëve në fushën e mjekësisë me njohuri të thelluara kërkimore, si dhe aftësi dhe kompetenca klinike/diagnostikuese në fushat përkatëse të mjekësisë, në përputhje me kërkesat dhe nevojat që ka vendi.	Programi i studimit të specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ka përcaktuar qartë objektivat: • Objektivat formuese plotësuese; • Objektivat formuese bazë; • Objektivat formuese të llojit të Programit; Objektivi parësor i programit të studimit është të trainojë specialistë të fushës, me aftësi klinike dhe menaxhuese të pacientit, sipas fushave përkatëse të kërkesës për asistencën e anesteziolit, si dhe njohuri të thelluara të kërkimit shkencor. Me qëllim që të arrijë këto objektiva, UNIZKM ka marrëveshje bashkëpunimi, dhe e ofron këtë program në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata". Ky bashkëpunim ndihmon Shkollën e Specializimit të adoptojë udhëzuesit Europianë dhe harmonizojë me programin e trainimit të përdorur në Itali. <i>Evidencë nr 33: Prezantimi i Programit të Specializimit "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive"; Evidencë nr 5: Marrëveshje kuadër bashkëpunimi midis UNIZKM me Universitetin e studimeve në Romë "Tor Vergata";</i>
Kriteri 3: Programi i specializimit afatgjatë hartohet dhe harmonizohet me programe të ngjashme të ofruar nga institucione partnere vendase apo të huaja, udhëzues, direktiva të BE, të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare me të cilat është partner apo bashkëpunon vendi ynë.	Bazuar në Urdhërin nr. 664 datë 28.12.2017, është theksuar që ky program ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata". Ky bashkëpunim mbështetet në "Marrëveshjen kuadër për bashkëpunim në zhvillimin e aktiviteteve formuese në fushën e mjekësisë dhe atë shëndetësore të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Tiranë, 15/2023. <i>Evidencë nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Univesrsitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë";</i>



	<i>Evidencë nr 5: Marrëveshje kuadër për bashkëpunim midis UKZKM me Unibersitetin e Studimeve në Romë 'Tor Vergata'</i>
Kriteri 4: Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar, mobilitetit dhe përfshirjen në veprimtaritë akademike të programit edhe të specialistëve/profesionistë të huaj, programi mund të aplikohet pjesërisht ose i plotë edhe në një nga gjuhët e BE-së.	Bazuar në takimin me Grupin e Vlerësimit të Bendshëm dhe studentët e programit të specializimit, programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" zhvillohet në gjuhën Italiane. Kjo jep mundësi për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe angazhimin e profesorëve dhe specialistëve italianë në dhënien e leksioneve por edhe trainimin klinik. <i>Evidencë : Takimi me GVB;</i> <i>Evidencë : Takim me studentët;</i>
Kriteri 5: Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.	Duke marrë në konsideratë numrin e ulët të specialistëve anestezistë, përqëndrimin e tyre në Tiranë, rritjen e numrit të ndërhyrjeve dhe procedurave kirurgjikale që kanë nevojë për asistencën e anestezistit, programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" synon të plotësojë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë. <i>Evidencë nr 34: Studimi i tregut Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive</i>
Kriteri 6: Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të Institucioneve të arsimit të lartë dhe strukturave shëndetësore të përfshira në rrjetin formues (në varësi kapaciteteve pritëse akademike/profesionale dhe infrastrukturore).	Bazuar në nenin 5 të rregullores së programit kuotat në dispozicion për pranim, tarifat përkatëse të shkollimit kushtet dhe procedurat specifike për pjesmarrje në këtë program studimi, përcaktohen çdo vit me Vendim të Senatit Akademik sipas propozimeve të Fakultetit të Mjekësisë. Sipas Vendimit nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Universitetit Katolik Zoja e Këshilit të Mirë", numri i studentëve të parashikuar për vit akademik ka qenë 4 (katër) student. Ky numër është vendosur bazuar në kapacitetet trainuese të strukturave shëndetësore me të cilat UNIZKM ka marrëveshje dhe të angazhuar në programin e specializimit specifik. <i>Evidencë nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në</i>



	<i>"Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Univesrsitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë;</i> <i>Evidence 41- Rregullore e programit të Specializimeve afatgjate ne Mjekesi, UKZKM,2019;</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit specializues afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ka si qëllim që të plotësojë nevojat që ka vendi për specialistë, sepse janë 175 anesteziistë, me një mesatare 6.11 për 100000 banorë. Përvec se janë pak specialistë, pjesa më e madhe e tyre (114) janë të përqendruar në Tiranë, dhe një pjesë prej tyre largohen jashtë vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi L6

Organizimi i programit të specializimit afatgjatë është në përputhje me fushën akademike dhe në bazë specialiteti.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1: Programi i specializimit afatgjatë organizohet në nivel njësie bazë ose shërbimi (pjesë përbërëse e departamentit) të cilat janë përgjegjës për mbarëvajtjen dhe ecurinë e tij.

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kirurgjikale Fakulteti i Mjeksisë në UNIZKM. Programi i studimit është i organizuar në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata" bazuar në marrëveshjet dypalëshe, ku përfshihen edhe programet e studimit të ciklit të tretë. Drejtuesi i programit të specializimit në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" është Prof. M. D., i emëruar me Dekret Nr.5 datë 29.01.2019, i cili është Professor pranë Universitetit të Romës "Tor Vergata".

Kriteri 2: Njësia përgjegjëse ka profilin,

Fakulteti Mjeksisë dhe Departamenti i Shkencave Kirurgjikale në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219

E-mail info: ascal.al

përvojën, kapacitetet dhe burimet e dubura në fushën akademike e mjekësore të specialitetit për ofrimin e programit të specializimit.

Fakulteti i Mjeksisë dhe Kirurgjisë në Universitetin "Tor Vergata" kanë eksperiencën, kapacitetet, burimet njerëzore dhe profesionale për ofrimin e programit të specializimit. Stafit akademik dhe udhëheqësit klinikë të anagzhuar në programin afatgjatë të specializimit në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", kanë profilin e duhur akademik dhe gradën / titujt (Profesor, Profesor Asociuar, Doktor i Shkencave).

Sipas (Evidence 65 - Tabela e stafit akademik tab 1.1) Fakulteti i Mjeksisë për vitin akademik 2023-2024 ka në përbërjen e tij staf akademik me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Mjeksisë	
	PAE	PAK
Prof. Dr.	26	4
Prof. Asoc.	62	8
Dr./PhD.	82	35
SPA	11	-
Msc	2	76
Gjithsej	183	123

Ndërsa njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Departamenti i Shkencave Kirurgjikale po në këtë vit akademik ka përbërjen si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Shkencave Kirurgjikale	
	PAE	PAK
Prof. Dr.	6	1
Prof. Asoc.	12	5
Dr./ PhD.	22	11
SPA	3	-
Msc	-	10
Gjithsej	43	27

Evidencë nr 65: Tabela e stafit akademik, tabela 2


Kriteri 3: Programet e studimit mbështeten mbi

Sipas prezantimit të programit të specializimit në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" dhe



objektiva të qartë profesionale dhe janë të integruar me veprimtaritë klinike/diagnostikuese.	rregullore së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", programi i studimit ka objektiva profesionale të qarta të integruara me aktivitete klinike dhe diagnostikuese. <u>Objektivat formuese plotësuese:</u> specializanti duhet të fitojë nocionet e psikologjisë klinike, gjenetikës mjekësore, mjekësisë së brendshme, si dhe njohuri në lidhje me kërkimet kryesore të laboratorit hematokimik, të diagnostikimit përmes imazheve radiologjike. <u>Objektiva formuese bazë:</u> specializanti duhet të fitojë njohuri specifike të fenomeneve fizike, biokimike dhe patofiziologjike të nevojshme për të aplikuar në mënyrë korrekte teknikat e anestezisë, terapi së anelgjezike dhe hiperbarike për të trajtuar pacientin kritik në terapi intensive, etj. <u>Objektivat formuese të llojit të programit:</u> specializanti duhet të fitojë njohuritë dhe aftësitë për të kryer një trajtim anestezik të duhur dhe të sigurt në të gjitha degët e kirurgjisë. Specializanti duhet të jetë në gjendje të përballojë dhe menaxhojë situata kryesore të urgjencave shëndetsore brenda dhe jashtë spitalore. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi UKZKM;</i> <i>Evidencë nr 33: Prezantimi i programit të specializimit në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive"</i>
Kriteri 4: Fusha specifike e programit të specializimit afatgjatë është në përputhje me fushën akademike të specialitetit të njësive përgjegjëse (departament/shërbim) për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e europiane.	Bazuar në Statutin e UKZKM, Rregulloren e Fakultetit të Mjekësisë dhe Njesisë bazë, Fusha specifike e programit të specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" është në përputhje me fushën akademike të specialitetit të Departamentit të Shkencave Kirurgjikale, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit në përputhje me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e europiane. <i>Evidencë nr 23: Statuti i UKZKM; Evidencë nr 24: Rregullore e Fakultetit të Mjekësisë;</i> <i>Evidencë nr 77: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Njesisë bazë;</i>

Kriteri 5: Në rastet kur programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera, fusha e specifikave e programit të specializimit është në përputhje me fushën akademike e të specialitetit të njësisë/ve përgjegjëse në institucionet respektive.	Bazuar në VBA nr 110 datë 10.11.2017 programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ofrohet nga UKZKM në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata". Njesia përgjegjëse në Universitetin e Romës "Tor Vergata" është Fakulteti i Mjeksisë dhe Kirurgjisë, që është në përputhje me fushën akademike e të specialitetit. <i>Evidencë nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Universitetit Katolik Zoja e Këshillit të Mirë";</i> <i>Evidencë nr 5: Marrëveshje kuadër për bashkëpunimin midis UKZKM me Universitetin e Romës "Tor Vergata";</i>			
Konkluzione	Organizimi i programit të specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ofrohet nga UKZKM në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata" dhe është në përputhje me fushën akademike e të specialitetit të specializimit. Njesia përgjegjëse në Universitetin e Romës "Tor Vergata" është Fakulteti i Mjeksisë dhe Kirurgjisë, që është në përputhje me fushën akademike e të specialitetit. Drejtuesi i programit të specializimit në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" është Prof. M. D. i emëruar me Dekret Nr.5 datë 29.01.2019, i cili është profesor pranë Universitetit të Romës "Tor Vergata".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT

Standardi II.1	
Organizimi i programit bazohet në rregullore dhe udhëzues të posaçëm të programit të specializimit afatgjatë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Njësia kryesore përgjegjëse për organizimin, zhvillimin e programeve të specializimeve, përcakton në mënyrë të detajuar rregullat e organizimit e të funksionimit të programeve të specializimeve dhe i përditëson ato në funksion të përmirësimit të cilësisë.	Bazuar në VBA nr 110 datë 10.11.2017 programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ofrohet nga Fakulteti i Mjeksisë, Departamenti i Shkencave Kirurgjikale në UKZKM janë njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të specializimit, në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata". IAL ka përgatitur rregullat e funksionimit të programit të specializimit të përditësuar bazuar në kornizën ligjore ekzistuese. UNIZKM ka hatuar rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë në fushën e mjeksisë që në vitin 2017, në vitin 2019 ka miratuar rregulloren e përditësuar të specializimeve dhe në vitin 2023 është miratuar rregullorja e re në përputhje me nevojat specifike të programeve të specializimeve. <i>Evidencë nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Universitetit Katolik Zoja e Këshilit të Mirë;</i> <i>Evidencë nr 5: Marrëveshje kuadër për bashkëpunimin midis UKZKM me Universitetin e Romës "Tor Vergata";</i> <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi në UKZKM;</i> <i>Evidence 40 - Rregullore e studimeve të Specializimit e vitit 2017.pdf;</i> <i>Evidence 41- Rregullore e programit të Specializimeve afatgjate ne Mjekesi, UKZKM,2019;</i>
Kriteri 2: Elementët e organizimi të programit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet, përcaktohen në rregulloren e specializimeve afatgjate	Bazuar në evidencat e dërguara nga IAL, Rregullorja e specializimit afatgjatë në Mjekësi, Rregullorja e Fakultetit të Mjeksisë dhe Statuti i UKZKM përbëjnë kornizën ligjore që rregullon elementët e organizimi të programit, përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet. Në rregulloren e programit janë të parashikuara organizimi dhe funksionimi i programit, struktura elementët, kapacitetet profesionale dhe pedagogjike,


dhe në akte të tjera të miratuara nga institucioni.	të drejtat dhe detyrimet e studentëve, arritjet e specializantëve dhe vlerësimi i tyre, kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve, etj. <i>Evidence 40 - Rregullore e studimeve të Specializimit e vitit 2017;</i> <i>Evidencë nr 41: Rregullore e specializimit afatgjatë në Mjekësi në UKZKM;</i> <i>Evidence 12 - Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, në UKZKM, 2023;</i> <i>Evidencë nr 23: Statuti i UKZKM; Evidencë nr 24: Rregullore e fakultetit të Mjekësisë.</i>			
Kriteri 3: Institucioni harton dhe miraton udhëzues, modele për raportimin, vlerësimin dhe arritjet e specializantëve gjatë gjithë vitit akademik dhe të studimeve.	UKZKM ka aprovuar përmes rregullores së specializimit afatgjatë në Mjekësi, prezantimit të programit të specializimit afatgjatë, drejtuesi klinik dhe Drejtori i Shkollës së Specializimit përgatitin raportin e aktivitetit klinik të studentit bazuar në planin vjetor të studentit. <i>Evidencë nr 41: Rregullore e specializimit afatgjatë në Mjekësi në UKZKM;</i> <i>Evidencë nr 3: Prezantimi i programit të specializimit Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive;</i> <i>Evidencë nr 42: Vlerësimi i Udhëheqësit klinik;</i>			
Konkluzione	<i>Programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ofrohet nga UKZKM në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", është i organizuar bazuar në rregulloren e programit të specializimit afatgjatë dhe udhëzuesve të tjerë të IAL. Rregulloret sigurojnë raportimin, vlerësimin dhe arritjet e specializantëve gjatë gjithë vitit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IL2

Përmbajtja e programit të studimit specializim afatgjatë organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në udhëzues të hapësirës evropiane në arsimin e lartë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1: Për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara, dhe përcaktimeve në shtojcën 1.	Sipas Urdhërit të MASR nr 664 datë 28.12.2017 të licensimit, programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" realizohet me 300 kredite, me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 5 vite akademike. <i>Evidence 4 - Ministerial Decree No. 664 dt 29.12.2017 "On the opening of the specialization programme"</i>
Kriteri 2: Kohëzgjatja e normale e programeve të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë është sipas shtojcës nr 1 dhe kohëzgjatja maksimale nuk mund të jete me shume se dyfishi i kohëzgjatjes normale të specializimit afatgjatë.	Sipas VBA nr 110 datë 10.11.2017 programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" kohëzgjatja e programit të jetë 5 vite akademike. Sipas Rregullorres së specializimit afatgjatë në Mjekësi UKZKM, Neni 36, zgjatja e studimeve nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohës normale. <i>Evidence nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Universitetit Katolik Zoja e Këshilit të Mirë";</i> <i>Evidence nr12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi UKZKM;</i>
Kriteri 3: Përmbajtja e programit, organizimi, vlerësimi dhe monitorimi përafrohen me shembuj të ngjashëm në institucione ndërkombëtare të hapësirës evropiane të arsimit të lartë.	Sipas VBA nr 110 datë 10.11.2017 programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" ofrohet në UKZKM në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata". Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit midis dy universiteteve, përmbajtja e programit të specializimit, organizimi, mbikqyrja dhe monitorimi i studentëve është i njëjtë me specializimin afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" që ofrohet në Itali. <i>Evidence nr 3: Vendimin nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë, program studimi afatgjatë specializues në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", të Universitetit Katolik Zoja e Këshilit të Mirë";</i>



	<i>Evidencë nr 5: Marrëveshje kuadër për bashkëpunimi midis UKZKM dhe Universitetin e studimeve në Romë "Tor Vergata2;</i>
Kriteri 4: Programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike/diagnostikuese e profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.	Sipas "Rregullores së programit të studimit SPA në Mjekësi në UKZKM", paragrafi II, Neni 7, Programet e Specializimeve afatgjata parashikojnë që të paktën 80% e krediteve (ECTS) totale të aktivitete klinike profesionalizuese, ti takojnë specializimit përkatës, ndërsa 20% ti takojnë studimeve teorike të shpërndara në vite sipas një programi të caktuar paraprakisht në fillim të programit të studimit. Sipas "Prezantimit të programit të specializimit në Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, janë 88 ECTS leksione frontale dhe 212 ECTS veprimtari praktike dhe praktika, dhe raporti midis tyre është 29.3%/70.7%. <u>Rekomandohet që Institucioni duhet të rishikojë raportin midis orëve teorike dhe veprimtarive klinike / diagnostikuese, sipas rregullores së programit të specializimit afatgjatë.</u> <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i> <i>Evidencë nr 33: Prezantimi i programit të specializimit Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive</i>
Kriteri 5: Raporti i lëndëve (referuar totalit të ECTS) të përcaktuara në programin e studimit përbëhet, nga: 60% lëndë specifike; 30% lëndë karakterizuese të fushës; 5% lëndë të formimit bazë, ndërdisiplinore ose integruese dhe për aktivitete të tjera; 5% provimi përfundimtar et j.; Jo me shume se 15% e totalit e lëndëve vjetore duhet të jenë lëndë me	Sipas "Rregullores së programit të studimit SPA në Mjekësi në UKZKM", paragrafi II, Neni 7, Programet e Specializimeve afatgjata parashikojnë që raporti i lëndëve të përcaktuara në programin e specializimit afatgjatë përbëhet nga: - 60% lëndë specifike të programit të specializimit; - 30% lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues; - 5% lëndë të formimit bazë, lëndë ndërdisiplinore ose plotësuese; - 5% për provimin përfundimtar; 15% i totalit të lëndëve specifike dhe 15% i totalit të lëndëve karakterizuese duhet të jenë lëndë me zgjedhje. Sipas Tabelës 9, raporti i krediteve të lëndëve sipas tipit të veprimtarisë, janë: 60% lëndë specifike - 200 ECTS / 300 ECTS = 66.6%;

zgjedhje, sipas kuadrit ligjor ne fuqi.	30% lëndë karakterizuese të fushës - 66 ECTS /300 ECTS = 22%; 5% lëndë të formimit bazë, lëndë ndërdisiplinore ose plotësuese - 9 ECTS /300 ECTS = 3%; 5% për provimin përfundimtar - 15 ECTS /300 ECTS = 5%; <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i> <i>Evidencë nr 79: Tabela përmbledhëse;</i>
Kriteri 6: Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik I lëndës i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor i lëndës kryhet nga një komision I përbërë nga të paktën 2 (dy) pedagogë. Nder ta, te paktën njeri prej tyre duhet te jete pedagog me kohe te plote ne fushën përkatëse ndërsa pedagogu i dyte specialist me përvojë i fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe indërpresin studimet e specializimeve afatgjata.	Sipas “Rregullores së programit të studimit SPA në Mjekësi në UKZKM”, <i>paragrafi II, Neni 14</i>, në përfundim të çdo viti akademik, organizohet një provim vlerësues teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga të paktën 5 (pesë) anëtarë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të, sipas moduleve të zhvilluara. Specializantët që vlerësohen jo kalues 5 (pesë) here rresht, marrin një certifikatë për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i>
Kriteri 7: Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili përfshin testimin praktik dhe me gojë të studentit dhe/ose	Sipas “Rregullores së programit të studimit SPA në Mjekësi në UKZKM”, <i>paragrafi II, Neni 15</i>, specializanti kryen provimin përfundimtar në fund të programit të specializimit, i cili konsiston në një testim praktik, një testim me gojë, prej të paktën 30 minutash, si edhe paraqitjen e temës eksperimentale – studimore të diplomës. Për këtë arsye ngrihet një komision prej të paktën 5 (pesë) ekspertësh të fushës, ose të një fushe të përafërt, me përvojë



paraqitjen e temës të diplomës. Komisioni për vlerësimin përfundimtar të studentit përbëhet nga 5 specialistë të fushës pedagogje me kohe te plote të IAL që ofron specializimin, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse. Kryetar i komisionit duhet te jete një pedagog me kohë te plote i fushës përkatëse, përgjegjës për programin e specializimit afatgjatë ne këtë fushe. Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë: a. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike; b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë; d. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente.	profesionale të paktën 10 (dhjetë) vjeçare dhe përvojë akademike në fushën përkatëse, ndër të cilët 2 përfaqësues nga MSHMS, 1 nga Urdhri profesional përkatës dhe 2 të përzgjedhur nga Fakulteti që zhvillon programin përkatës të specializimit, sipas akteve legjislativë në fuqi. Pjesë e testimit përfundimtar janë disa nga njohuritë bazë si: a. Vlerësimi i arsytimit kritik në trajtimin e rasteve komplekse klinike; b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë; d. Aftësi për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në raste emergjente. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM</i>
Kriteri 8: Në kuadër të përmirësimit të programit, njësia përgjegjëse ka të drejtën e ndryshimeve në përmbajtje të formimit teorik të programit të	Sipas Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" njësia përkatëse mund të bëjë ndryshime të përmbajtjes së programit deri në 20% vetëm pasi ka kaluar akreditimin e parë. <i>Ky është procesi i akreditimit të parë të programit të studimit.</i>

specializimit, dokumenton procedurën në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Programi i specializimit afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" është i organizuar në 5 vite akademike dhe 300 ECTS. Sipas "Prezantimit të programit të specializimit në Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive, janë 88 ECTS leksione frontale dhe 212 ECTS veprimtari praktike dhe praktika, dhe raporti midis tyre është 29.3%/70.7%.</i> <u>Rekomandohet të rishikohet raporti midis orëve teorike dhe veprimtarive klinike / diagnostikuese, sipas rregullores së programit të specializimit afatgjatë. Provimi për fundimtar kryhet sipas kornizës ligjore dhe rregullores së specializimit afatgjatë.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) në Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) në Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare	Sipas rregullores së specializimit afatgjatë dhe pranimi të studentëve në specializimin afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", studenti duhet të ketë përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë në Mjeksi të Përgjithshme, pranë një universitetit të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare "Master i Shkencave". Cdo vit UKZKM publikon në websitin e saj thirrjen për aplikim, ku kriteret për pranimin janë sipas rregullores së lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, e cila përcakton procedurat e pranimi dhe afatet për aplikim. Studentët e diplomuar jashtë vendit duhet të paraqesin diplomën e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, dhe licensën nga Urdhëri i mjekut përkatës. Për studentët që janë diplomuar në vendet Perëndimore dhe kanë marrë diplomën përkatëse për të praktikuar profesionin në vendet e tyre, nuk kërkohet notë mesatare për pranimin në programin e

"Master i Shkencave". Për studentët e diplomuar në të njëjtat programe jashtë shtetit, duhet të paraqesin diplomën dhe lejen për ushtrimin e profesionit të njohur nga institucioni shtetëror përgjegjës.	specializimit afatgjatë. Lista e vendeve përëndimore përcaktohet nga një urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nga kontrolli i një dosje studenti, kishte diplomën në Mjeksi të Përgjithshme si dhe Licensën nga Urdhëri i mjekut. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i> <i>Evidencë : Vizitë në Sekretarinë Mësimore, kontroll i një dosje studenti;</i>
Kriteri 2: Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimi për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.	Sipas rregullores së specializimit afatgjatë dhe pranimit të studentëve në specializimin afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive", kandidatët që aplikojnë për t'u futur në ciklin e tretë të studimeve, duhet t'i nënshtrohen konkurimit për të testuar njohuritë. Sipas Urdhërit Nr. 78 Prot datë 27.02.2024 të Zv. Rektorit për programet e specializimit Prof. Giovanni Arcudi, përcaktohet Komisioni për konkursin e pranimit për programet afatgjatë në fushën e Mjekësisë, përbërë nga profesorët: Giovanni Arcudi, Bruno Zappacosta, Arvin Dibra, Umberto Tarantino, Dr. Sadmira Gjergji. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi,</i> <i>Evidencë nr 46: Komisioni i vlerësimit për pranim</i>
Kriteri 3: Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë kumulative duke vlerësuar të paktën elementët e mëposhtëm: • notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo më shumë se 30% të pikëve totale, • testimin e përgjithshëm me	Sipas rregullores së specializimit afatgjatë dhe pranimit të studentëve në specializimin afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" dhe provave të vëzhguara gjatë vizitës në institucion (dosja e studentit), vlerësimi i studentit për pranimin në programin e studimit, bazohet në mbledhjen e pikëve sipas elementëve të mëposhtëm: • provim me shkrim për njohuritë e përgjithshme me 30% të pikëve; • provim me shkrim për njohuritë specifike sipas programit të specializimit për të cilin konkuron student me 40% pikëve; • nota mesatare për 20% të pikëve; • intervista me gojë me 10% të pikëve;

shkrim për 30-40% të pikëve totale, • testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkurron për 40-50% të pikëve totale.	<i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM; Evidencë:</i> <i>Vizitë në Sekretarinë Mësimore, kontroll i një dosje studenti</i>
Kriteri 4: Kandidati që aplikon në programet e ciklit të tretë specializim afatgjatë duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (njohur në RSH). Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues në një IAL sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.	Sipas rregullores së specializimit afatgjatë dhe pranimi të studentëve në specializimin afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" dhe provave të vëzhguara gjatë vizitës në institucion (dosja e studentit), studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në Mjekësi të Përgjithshme ose ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj (i njohur në RSH). Në dosjen e studentit u gjet Licensa nga Urdhëri i Mjekut. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM; Evidencë : Vizitë në Sekretarinë Mësimore, kontroll i një dosje studenti</i>
Kriteri 5: Kriteret minimale për t'u kualifikuar në përzgjedhjen e programit të studimit specializim afatgjatë janë të pasqyruara në rregulloren e programeve të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe	Sipas rregullores së specializimit afatgjatë dhe pranimi të studentëve në specializimin afatgjatë në "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive" në <i>Nenin 20</i>, janë të pasqyruara kriteret minimale për t'u kualifikuar në programin e studimit specializim afatgjatë, miratuar me vendim të SA Nr. 239/2 Prot datë 13.06.2019. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i> <i>Evidencë nr 48: Minutat e Senatit Akademik;</i>

të aprovuara nga Senati Akademik.				
Kriteri 6: Aplikanti njihet me rregulloren e specializimeve afatgjata të miratuar nga Senati akademik i IAL, me kriteret minimale të pranimit, në faqen zyrtare të IAL dhe/ose njësisë kryesore, para se të pranohet në të.	Sipas rregullores së specializimit afatgjatë dhe pranimit të studentëve në specializimin afatgjatë në “Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive” në <i>Nenin 21</i>, çdo kandidat në momentin e regjistrimit për në konkursin e specializimit, i jepen: - Kopje e formularit të aplikimit e firmosur nga palët dhe me vulë të Fakultetit përkatës; - Rregullorja e konkursit ose adresa web ku mund ta konsultojë atë; - Të dhënat për datën e kontrollit të dokumentacionit nga ana e Komisionit të Vlerësimit si dhe ku mund të informohet lidhur me vendin dhe orën e konkursit si dhe rezultatin përfundimtar; <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i>			
Konkluzione	<i>Procesi i pranimit të studentëve në specializimin afatgjatë në “Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive” është organizuar sipas kornizës ligjore të miratuar nga Senati Akademik. Çdo informacion është public dhe çdo kandidat informohet përmes formës elektronike në faqen e universitetit ose në hard copy që i dorëzohet në momentin e regjistrimit për në konkurs.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IL4	
Hartimi dhe miratimi i rregullores së specializimeve afatgjata.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në fushën e mjekësisë dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	Rregullorja e specializimit afatgjatë dhe pranimit të studentëve në specializimin afatgjatë është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Dekretin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 824, datë 24.12.2021 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të

	specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Institucionet e Arsimit të Lartë”; Dekretin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 1 të datës 14.01.2020, të ndryshuar “Për dokumentacionin dhe procedurat e hapjes, riorganizimit dhe mbylljes së institucionit të arsimit të lartë, degëve të tij, njësive të tij kryesore dhe programeve të tij të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucioneve të arsimit të lartë”. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i>
Kriteri 2: Rregullorja hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik. Nëse ska ndryshime, është në fuqi rregullorja e fundit e përditësuar.	Rregullorja e specializimit afatgjatë ka hyrë në fuqi në fillim të vitit të parë akademik në v.2017 dhe është përditësuar bazuar në ndryshimet që ka pësuar korniza ligjore. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM; Evidencë nr 40: Rregullore e studimit të spexializimit 2017; Evidencë nr 41: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM, 2019;</i>
Kriteri 3: Përditësimet në rregulloren e specializimeve afatgjata i përkasin ciklit të specializimit që fillojnë për herë të parë me rregulloren e përditësuar deri në përfundim të tij. Nëse është të nevojshme, ndryshimet në rregulloret pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.	Rregullorja e specializimit afatgjatë ka hyrë në fuqi në fillim të vitit të parë akademik në v.2017 dhe është përditësuar në vitin 2019 dhe 2023 bazuar në ndryshimet që ka pësuar korniza ligjore. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i> <i>Evidencë nr 40: Rregullore e studimit të spexializimit 2017;</i> <i>Evidencë nr 41: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM, 2019;</i>
Kriteri 4: Rregullorja propozohet nga Njësia kryesore që ofron programin e specializimeve dhe aprovohet nga senati akademik i IAL.	Rregullorja e specializimit afatgjatë propozohet nga Njësia kryesore që ofron programin e specializimeve (Fakulteti i Mjekësisë) dhe aprovuar nga senati akademik i IAL. <i>Evidencë nr 48: Procesverbali i Senatit Akademik</i>
Konkluzione	<i>Rregullorja e specializimit afatgjatë është aprovuar nga Senati Akademik i UKZKM, nr. 239/2 datë 13.06.2019. Rregullorja e</i>

	<i>përditësuar përmban kornizën ligjore më të fundit në fushën e standarteve të arsimit të lartë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IL5

Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Në rregullore pasqyrohen qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjësit të programit të specializimit, sipas përcaktimeve në këto standarde.	Rregullorja e specializimit afatgjatë <i>Neni 9</i> përcakton, përgjegjësi i Programit të Specializimit duhet të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar", ose një kualifikim të përfutur në vende perëndimore të barasvlershëm me këtë titull, dhe 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit lidhur me specializimin. Prof. M. D. është Profesor i Asociuar i Anestezisë dhe Reanimacionit në Universitetin Tor Vergata, dhe emëruar me Dekret nr.05 datë 29.01.2019 të Rektorit. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i> <i>Evidencë nr 39: Emërimi i Drejtorit të Specializimit Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi Intensive;</i> <i>Evidencë nr 49: CV Prof. Mario Dauri;</i>
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij.	Rregullorja e specializimit afatgjatë <i>Neni 12</i>, përcakton se specializanti ka një tutor (udhëheqës klinik) që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për orientimin, këshillimin dhe vlerësimin e nevojave të tij si edhe për monitorimin e punës së specializantit. Përvoja profesionale dhe klinike e udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit të specializimit që ndjek specializanti. Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqen nga një tutor është 3 (tre). Udhëheqësi (tutori) mund të punojë me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues si dhe duhet të ketë një kontratë bashkëpunimi me strukturën e lidhur gjatë kohëzgjatjes së programit të specializimit. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi, UKZKM;</i>

Konkluzione	<i>Rregullorja e specializimit afatgjatë ka të mirë përcaktuara kriteret për drejtuesit e programit të specializimit dhe mentorin klinik, bazuar në kërkesat ligjore.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IL6

Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe titulli i diplomës që kërkohet etj) si dhe kriteret përjashtuese nëse ka të tilla.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, <i>Neni 16</i>, aplikantët duhet që të kenë përfunduar programe të integruara studimesh të ciklit të dytë në Mjekësi të Përgjithshme ose Farmaci, në një universitet të akredituar për programin në fjalë, dhe që kanë diplomë "Master i Shkencave" në një nga programet e mësipërme të studimit, si dhe ata që kanë diplomë "Master i Shkencave" të marrë jashtë Republikës së Shqipërisë por të njohur nga MASR dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për studentët e diplomuar në të njëjtat degë jashtë shtetit në vende perëndimore të cilëve u njihet diploma për ushtrimin e profesionit përkatës në këto vende, nuk kërkohet kriteri për notën mesatare për t'u pranuar në programet e specializimeve afatgjata në Mjekësi. Aplikantët duhet të kenë dhënë provimin e shtetit sipas Ligjit Nr.10171 datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" dhe fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, <i>Neni 20</i> , dhe Shpalljes konkursit <i>Neni 5</i> , kandidatët duhet të plotësojnë:

dokumentacionit dhe afati përfundimtar.	1- Formular përshkrimi / Moduli A : https://admission.unizkm.al ose website www.unizkm.al; 2- Diplomë dhe listë notash për çdo provim; 3- Certifikata origjinale e diplomimit; 4- Kopje e noterizuar e Licensë së Profesionit; 5- CV në gjuhën italiane ose angleze; 6- Kopje e ID; 7- Tituj të tjerë ose punime shkencore. Aplikimi fillon jo më vonë se 2 javë dhe mbyllet 7 ditë para vlerësimit të dokumenteve. Lista e kandidatëve publikohet jo më vonë se 2 ditë para konkurimit. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë nr 44: Njoftim i konkursit specializimet afatgjata në fushën e Mjekësisë.</i>
Kriteri 3: Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Neni 24, është parashikuar një sistem vlerësimi prej 100 pikësh për çdo kandidat, të ndarë si më poshtë: - 30 pikë-testi mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës; - 40 pikë-testi mbi njohuritë specifike të programit të specializimit; - 20 pikë-nota mesatare e ponderuar e kandidatëve të cilët kanë marrë diplomën në Shqipëri dhe nota e Diplomës e kandidatëve të diplomuar jashtë shtetit; - 10 pikë- intervista me gojë; <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i>
Kriteri 4: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e aplikimit, e konkurimit e kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumenteve.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, Neni 20, përcakton qartë procedurat e aplikimit nga kandidatët për specializantë dhe pranimin në konkursin e specializimit. Aplikimet për specializim do të vlerësohen nga një Komision Special i përbërë nga 4 Profesorë, të përcaktuar me Dekret nr.78 datë 27.02.2024. Aplikimi fillon jo më vonë se 2 javë dhe mbyllet 7 ditë para vlerësimit të dokumenteve.

	<i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i>
Kriteri 5: Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e zhvillimit të testimeve dhe procedura e tyre.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, dhe "Shpalljes konkursit" është qartësisht e përcaktuar se studentët i nënshtrohen provimit me shkrim dhe me gojë. sistem vlerësimi prej 100 pikësh për çdo kandidat, të ndarë si më poshtë: - 30 pikë-testi mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës; - 40 pikë-testi mbi njohuritë specifike të programit të specializimit; - 20 pikë-nota mesatare e ponderuar e kandidatëve të cilët kanë marrë diplomë në Shqipëri dhe nota e Diplomës e kandidatëve të diplomuar jashtë shtetit; - 10 pikë- intervista me gojë; <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i>
Kriteri 6: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, <i>Neni 22</i>, përcakton procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve. Komisioni i Vlerësimit të pranimeve ngrihet nga Rektori i Universitetit, me propozim të Dekanit, dhe ka në përbërje të tij të paktën 3 (tre) anëtarë të zgjedhur nga personeli akademik me një përvojë profesionale specifike. Kryetari i Komisionit të Vlerësimit mbledh komisionin, drejton diskutimet, koordinon punën dhe siguron zbatimin e ligjit, të statutit dhe të kësaj Rregulloreje. Komisioni i Vlerësimit shprehet nëpërmjet vendimeve që merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i>
Kriteri 7: Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specializantëve që do të	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë, dhe "Shpalljes konkursit" janë qartësisht të përcaktuar emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik dhe numri i specializantëve që do të pranohen për çdo program specializimi

pranohen për çdo program specializimi dhe tarifat që duhet të paguajë specializanti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.	(Neni 9), tarifat që duhet të paguajë specializanti për çdo specializim (Neni 7), dhe publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve (Neni 5). <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë nr 44: Njoftimi i konkursit program i studimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë;</i>
Kriteri 8: Mënyra e vlerësimit mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.	Sipas "Njoftimit për konkurs" për vitin akademik 2023-2024, Neni 6, "Mënyra e seleksionimit" është parashikuar një sistem vlerësimi prej 100 pikë për çdo kandidat, të ndarë si më poshtë: - 30 pikë-testi mbi njohuritë e përgjithshme të lëndës; - 40 pikë-testi mbi njohuritë specifike të programit të specializimit; - 20 pikë-nota mesatare e ponderuar e kandidatëve të cilët kanë marrë diplomën në Shqipëri dhe nota e Diplomës e kandidatëve të diplomuar jashtë shtetit; - 10 pikë- intervista me gojë; Publikimi i kriterëve të vlerësimit është bërë të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë nr 44: Njoftimi i konkursit program i studimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë;</i>
Kriteri 9: Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.	Sipas "Njoftimit për konkurs" për vitin akademik 2023-2024, Neni 6, Provimi do të kryhet në datë 27.02.2024 dhe rezultatet do të bëhen publike 04.03.2024, në faqen zyrtare të UKZKM http://www.unizkm.al. <i>Evidencë nr 44: Njoftimi i konkursit program i studimit afatgjatë në fushën e Mjekësisë.</i>
Kriteri 10: Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specializantët fitues.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", paragrafi IV, Të drejtat dhe detyrimet e studentit të një programi studimi Specializimi afatgjatë në fushën e Mjekësisë, nga Neni 26-40 përshkruhen elementët e kontratës midis Universitetit dhe studentit fitues.

	Në dosjen e studentit kemi gjetur kontratë të nënshkruar midis palëve. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë : Vizitë në sekretarinë mësimore, dosja e studentit;</i>			
Konkluzione	<i>Rregullorja e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" përcakton qartë mënyrën e aplikimit, kriteret dhe dokumentet që kërkohen, mënyra e vlerësimit, pikër që merren gjatë ekzaminimit, mënyra e publikimit të fituesve dhe lidhja e kontratës midis Universitetit dhe kandidatit fitues.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IL7

Në rregullore parashikohen element të procesit mësimor të programit specializues.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Parashikohen në rregulloren e specializimeve mënyra e frekuencimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsyt, leja e lindjes, dhe mënyra e rikuperimit të mungesave etj.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Neni 34-35, përcaktohet se studenti specializant merr pjesë aktive në të gjithë aktivitetin e strukturave klinike dhe universitare ku kryen specializimin gjithmonë nën përgjegjësinë e pedagogëve, tutorëve dhe mjekëve specialistë të rrjetit formues. Specializanti duhet të plotësojë të gjitha detyrat që i besohen duke respektuar Rregulloren dhe strukturat të rrjetit formues ku punon gjatë periudhës së specializimit. Specializanti ka të drejtën e pushimit 4 javor në vit në periudhën e parashikuar në strukturën didaktike-klinike të rrjetit formues. Koha e pushimit vjetor përcaktohet në marrëveshje me drejtuesit e specializimit përkatës. Për mungesat për arsye shëndetësore, duhet të depozitohet raport mjekësor. Në rast se mungesat janë më shumë se 30% e ciklit apo modulit mësimor, ky i fundit duhet përsëritur. Në rast leje lindjeje, specializimi do të shtyhet për aq kohë sa është leja e lindjes, në mënyrë që të kryhet i plotë programi teorik e praktik. Në raste fatkeqësish familjare, specializanti mund të mungojë për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë dhe duhet të shlyejë detyrimet në një moment të dytë.

	<i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>
Kriteri 2: Parashikohen ne rregulloren e specializimeve procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Neni 42, student ka të drejtë të transferohet në vite të ndërmjetme (maksimalisht viti i dytë) në të tjera programe specializimi afatgjatë pas shqyrtimit të dosjes përkatëse nga Komisioni i ngritur nga Programi i Specializimit ku ka synim të transferohet. Transferimi i studimeve specializuese afatgjata mund të kryhet vetëm nëse janë parashikuar kuota specifike për këtë qëllim. Procedurat e njehsimit dhe transferimit bëhen në përputhje me këtë rregullore dhe ligjin në fuqi. Në rast se numri i transferimeve është më i madh se kuotat e parashikuara nga institucioni, kandidatët do të nënshtrohen konkurrimit. Nuk kishte ndonjë rast transferimi për të vëzhguar procedurën e kryer. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>
Kriteri 3: Parashikohen ne rregulloren e specializimeve kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specializantit nga studimet specializuese.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Neni 44. Konsiderohen shkelje të Rregullores së programit të studimeve afatgjata të specializimit, të gjitha veprimet e kryera nga ana e studentit që çojnë personalitetin dhe integritetin fizik dhe moral të të tjerëve, rregullat dhe normat etike – morale të shoqërisë, mosrespektimi i kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, në rastet kur këto veprime nuk kanë elemente të veprave penale. Për veprimet e mësipërme të kryera në mjediset e rrjetit formues gjatë vitit akademik merren këto masa disiplinore: a) Këshillim me shkrim; b) Vërejtje me shkrim; c) Pezullim nga specializimi për vitin akademik; d) Çregjistrim nga specializimi; Nuk kishte ndonjë rast të pezullimit nga studimet deri në momentin e vizitës në institucion.

	<i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>			
Kriteri 4: Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues shqiptar, kohëzgjatjen e kësaj periudhe dhe organin aprovues të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", <i>Neni 38</i>, Specializanti ka të drejtë që një pjesë të periudhës së specializimit, ta kryejë në strukturat e tjera jashtë shtetit që bëjnë pjesë në rrjetin formues të programit të Specializimit, me miratimin e Këshillit të Programit të Specializimit dhe Dekanit të Fakultetit. Institucionet e arsimit të lartë, ku specializanti do të kryejë një pjesë të studimeve, duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit të specializimit në vendin përkatës. Programi i specializimit afatgjatë në Anestezilogji, Reanimacion dhe Terapi intensive kryhet në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata" i cili është i akredituar nga institucionet përkatëse në Itali. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë nr 10: Akreditimi nga ANVUR i "Tor Vergata".</i>			
Konkluzione	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", është e mirë përcaktuar forma e ndjekjes së studimeve, mungesat, transferimi nga ose në specializime të tjera, shkëlqja e rregullores dhe kriteret për pezullim, dhe procedurat si student mund të kryejë një pjesë të specializimit jashtë vendit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IL8	
Në rregullore parashikohen element të procesit mësimor të programit specializues	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja parashikon librezën e aktivitetit praktik së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", <i>Neni 43</i> , në fillim të programit të studimeve të specializimeve afatgjata, specializanti pajset me Librezën e Studentit, ku do të shënohen të gjitha notat dhe vlerësimet vjetore të tij. Libreza e Studentit e shoqëron specializantin deri në përfundimin e ciklit specializues dhe

Libreza e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij	diplomimin e tij. Libreza lëshohet në momentin e regjistrimit të studentit dhe përmban dhe foto të studentit. Për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin përkatës specializues, të cilat përmbajnë vlerësim apo kërkohet të certifikohet frekuentimi, studenti paraqitet me librezë e cila, në përfundim të aktivitetit përkatës plotësohet nga pedagogu që ka qenë përgjegjës për zhvillimin e atij aktiviteti. Plotësimi i librezës është i detyrueshëm. Kandidati nuk pranohet në aktivitetet përkatëse nëse nuk paraqet librezën. Në rastet kur studenti humbet librezën, sekretaria përkatëse e pajis atë me një librezë tjetër kundrejt kërkesës së studentit dhe pagesës së parashikuar, si dhe plotëson në librezë aktivitetet e shlyera deri në atë moment nga studenti, të cilat rezultojnë në aktet e sekretarisë. Libreza dorëzohet në sekretarinë përkatëse në përfundim të programit specializues. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>			
Konkluzione	<i>Studenti në specialimin afatgjatë pajiset me librezën e aktivitetit praktik në fillim të programit të studimit. Të gjitha aktivitetet klinike dhe akademike shkruhen në librezë. Institucioni ka parashikuar procedurat për zëvendësimin e librezës në rast se humbet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.9

Në rregullore parashikohen procedurat për testimet vjetore dhe testimin përfundimtar si dhe formati i diplomës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Në rregullore përcaktohet mënyra e testimit vjetor të lëndëve dhe ai përfundimtar të specializantëve, pikët minimale dhe maksimale, lloji i testit, etj.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Neni 32, specializanti vlerësohet me notë në fund të çdo viti, notë e cila depozitohet në sekretarinë e ngarkuar për këtë qëllim. Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar vetëm pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve vjetore, të parashikuara në program dhe pas miratimit të dosjes së tij nga Këshilli i programit të specializimit. Vlerësimi përfundimtar vjetor i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike, në provimin

	përfundimtar dhe në temën eksperimentale të Diplomës, si dhe në gjykimin e pedagogëve dhe të udhëheqësit dhe bëhet me anë të një sistemi notash deri në dhjetë, ku minimumi për të kaluar provimin është 5 ndërsa maksimumi është 10. <i>Nuk mundëm të shikonim një procedurë diplomimi sepse nuk kishte ndonjë student të diplomuar akoma.</i> <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohen rastet e mungesave të justifi kuara në testime dhe mënyra e rikuperimit të testimit në këto raste.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Neni 37, kur specializanti që nuk kalon vlerësimin përfundimtar, ka të drejtë t'i nënshtrohet edhe një herë tjetër këtij vlerësimi, por jo më vonë se 1 (një) vit pas përfundimit të specializimit. Studenti regjistrohet si student përsëritës dhe paguan tarifën e plotë të shkollimit për vitin që ndjek. Gjatë këtij viti studenti frekuenton aktivitetet përkatëse profesionale me kohë të plotë. Specializanti, i cili nuk i është nënshtruar vlerësimit përfundimtar brenda 1 (një) viti nga përfundimi i specializimit, humbet të drejtën e marrjes së Diplomës së Specializimit, por atij i jepet një certifikatë që vërteton se ka kryer ciklin e plotë të studimeve të specializimit, përveç diplomimit, si dhe lista shoqëruese e notave të marra dhe aktiviteteve të kryera, bashkë me kreditet përkatëse. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>
Kriteri 3: Në përfundim të studimeve të specializimit afatgjatë, I diplomuari pajiset me diplomën e specializimit. Diploma duhet të firmoset nga rektori i IAL dhe dekani i fakultetit përkatës	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Neni 32, specializantit që shlyen të gjitha detyrimet teorike dhe praktike, sipas planit mësimor dhe që ka marrë vlerësimin përfundimtar, i lëshohet një Diplomë Specializimi në specialitetin përkatës duke fituar kështu të drejtën e ushtrimit të profesionit si specialist. Formati i Diplomës, i miratuar nga Senati Akademik, komunikohet për efekt regjistrimi në regjistrin shtetëror të diplomave pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, sipas parashikimeve të bazës ligjore në fuqi. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>
Konkluzione	<i>Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", përcaktohen qartë procedurat finale</i>

	të vlerësimit, cfarë ndodh nëse student nuk jep provimin final, dhe mënyra e lëshimit të Diplomës nga Univeristeti.		
Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.10	
Të drejtat dhe detyrimet e specializantit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Rregullorja duhet të përmbajë detyrat dhe të drejtat që ka specializanti.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", <i>Paragrafi IV</i>, "Të drejtat dhe detyrimet e studentit të një programi studimi Specializimi afatgjatë në fushën e Mjekësisë", përmban detyrat dhe të drejtat që ka specializanti. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi</i>
Kriteri 2: Në rregullore përcaktohet tipologjia dhe mënyra e sigurimit të specializantëve gjatë kryerjes së specializimit. Parashikohet tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", <i>Neni 29</i>, studenti është i siguruar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin e specializimit. Studenti sigurohet për përgjegjësinë profesionale për dëmet që mund t'u shkaktojë të tretëve, si dhe për dëmet që mund t'i shkaktohen atij, gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara në programin e specializimit. Masa e mbulimit të policës së sigurimit është: - Policë Sigurimi për Specializantët: mbrojtje deri në 1.000.000 lekë; - Policë e Përgjegjësisë Profesionale ndaj të Tretëve: mbrojtje deri në 5.000.000 lekë. Polica e sigurimit, në favor të studentit, paguhet dhe lidhet nga Fakulteti përkatës me kompaninë e sigurimit; <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë nr 57: Policë sigurimi.</i>
Kriteri 3: Parashikohen rastet kur mund të	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik

pezullohet specializimi nga ana e specialistit dhe periudha maksimale e lejuar për pezullim, si dhe procedurat për të hequr dorë nga specializimi.	"Zoja e Këshillit të Mirë", Neni 36, specialisti nuk lejohet të përsërisë vitin, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 35. Specializimi nuk mund të zgjasë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes së saj zyrtare. Kur një specialist dëshiron të pezullojë studimet në Programin e Specializimit në "Anestezi, Reanimacion dhe Terapi Intensive" duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim për statusin e pezulluar të Rektori, duke e depozituar atë personalisht në sekretariatin mësimor ose me anë të një delegati të autorizuar me prokurë. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në M.jekës</i> <i>Evidencë nr 58: Aplikim pwr statusin e pezulluar</i>			
Kriteri 4: Në rregullore përcaktohen tregues të matshëm lidhur me plagjiaturën të punimit të diplomës si dhe referenca lidhura me to duke u kujdesur që niveli i ngjashmërisë të punimit të diplomës të jenë nën 30%.	Universiteti "Zoja e Këshillit të Mirë" ka platform antiplagjiaturë duke përdorur platformën Google for Education, ku pedagogëve u jepet leja për të përdorur platformën nga Zyra e Informatikës, për të verifikuar praninë e plagjiaturës së mundshme në temën eksperimentale, e cila paraqitet para Komisionit. Komisioni do të vendosë nivelin e pranueshëm të ngjashmërive të temës së diplomës me studimet e tjera shkencore. Platforma është si më poshtë : https://cdu.google.com/workspace-for-education/assignments/originality/ <i>Evidencë nr 60: Linku platformës antiplagjiaturë</i>			
Konkluzione	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka të shkruar detyrimet dhe të drejtat e studentit, kur pezullohen studimet ose tërhiqet nga studimet. Rregullorja përcakton sigurimin e studentit gjatë periudhës së specializimit për përgjegjësitë profesionale ndaj palëve të treta, ose dëmtimeve që mund të krijohen atij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IL11

Njësisë kryesore përgjegjëse për programin e specializimit administron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo specialist nga aplikimi, pranimi deri përfundim të studimeve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e aplikantëve në fazën e aplikimit.	Gjatë vizitës në IAL dhe Sekretarinë mësimore, mësuam se është strukturë nën varësinë e Fakultetit të Mjekësisë, dhe është përgjegjëse për mbajtjen e gjithë dokumentacionit e nevojshëm për programin e specializimit, duke përfshirë që nga aplikimi për konkursin deri te dosja përfundimtare e studentit. Gjatë vizitës vëzhguam dosje të studentëve, një student shqiptar dhe një italian. Sekretaria mban gjithë dokumentacionin e nevojshëm në letër dhe në formë elektronike. <i>Evidencë: Vizitë në IAL, Sekretaria mësimore</i>
Kriteri 2: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e procesit të përzgjedhjes dhe vendimmarrjes të kandidatëve aplikantë dhe fitues dhe garanton transparencë në vendimmarrje e proceset e ankimimit.	Sekretaria mësimore e Fakultetit të Mjekësisë, mban në formë elektronike dhe në letër të gjithë dokumentacionin e procesit të konkurimit për programin e specializimit. Sekretaria organizon procesin e regjistrimit, vendosjen e numrit të matrikullimit çdo student, regjistron informacionin personal të çdo student, notat e marra çdo vit shkollor. Gjatë vizitës vëzhguam dosje të studentëve, një student shqiptar dhe një italian. Sekretaria mban gjithë dokumentacionin e nevojshëm në letër dhe në formë elektronike. <i>Evidencë: Vizitë në IAL, Sekretaria mësimore</i>
Kriteri 3: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër të dhënat e çdo specialisti në lidhje me veprimtaritë akademike dhe kërkimore eksperimentale gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve.	Sekretaria mësimore në Fakultetin e Mjekësisë, mban në formë elektronike dhe në letër, raportet e drejtuesve klinikë, lektorëve, dhe notat e provimeve. Gjatë vizitës vëzhguam dosje të studentëve me gjithë dokumentacionin e nevojshëm në letër dhe në formë elektronike. <i>Evidencë: Vizitë në IAL, Sekretaria mësimore</i>
Kriteri 4: Njësia kryesore mban në formë elektronike dhe në letër raportimet, komunikimet zyrtare, vlerësimet e lëndëve dhe të progresit të specialistit.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit të specializimit afatgjatë, mentorët klinikë dhe lektorët akademikë përgatitin raporte për studentin, për anën akademike dhe profesionale, të cilat mbahen në formë elektronike dhe në letër nga Sekretaria mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore vëzhguam dosje të studentit, ku ishin raporte për aktivitetin klinik nga ana e mentorit klinik, dhe opinion i mentorit për kalimin e studentit në vitin tjetër akademik. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë: Vizitë në IAL, Sekretaria mësimore</i>

Kriteri 5: Njësia kryesore ve në dispozicion të studentëve sistemin elektronik antiplagjiaturë si dhe mekanizma tjerë të vetëkontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale.	Sipas rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”, Neni 33 Fakulteti i Mjekësisë vendos në dispozicion të studentëve të programit të specializimit afatgjatë sistemin elektronik antiplagjiaturë si dhe mekanizma tjerë të vetëkontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale, si më poshtë: https://edu.google.com/workspace-for-education/assignments/originality/ <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i>			
Kriteri 6: Njësia kryesore harton në mënyrë periodike raportime mbi ecurinë e programit të specializimit.	Drejtuesi i programit të specializimit afatgjatë në “Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive” Prof. G. M. përgatit raport periodik (vjetor) për ecurinë e programit të specializimit të cilin ai drejton. <i>Evidencë shtesë nr.2 : Relacion për mbarevjtjen e SPA Anestesiologji</i>			
Konkluzione	Fakulteti Mjekësisë është njësia përgjegjëse për programin e specializimit afatgjatë në Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, dhe administron përmes Sekretarisë mësimore gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo specializant , duke filluar nga aplikimi. Pranimi dhe deri në përfundim të studimeve. Njësia kryesore përgatit raport vjetor për ecurinë e programit të specializimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË

Standardi III.1

Njësia përgjegjëse garanton personelin e nevojshëm akademik, administrativ dhe mbështetës për zhvillimin e programit dhe realizimin e objektivave të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																														
Kriteri 1: Personeli akademik i angazhuar në programin e specializimit afatgjatë është i kategorisë profesor (profesor, profesor i asociuar), i kategorisë lektor (Dr/Phd), të cilët janë të angazhuar me punë klinike/diagnostikuese të paktën 10 vite eksperiencë.	Sipas tabelës nr.2 “Stafi akademik për programin e ciklit të studimit të ciklit të tretë specializim në Anestezilogji, Reanimacion dhe Terapi intensive, numri dhe kualifikimi i stafit akademik të angazhuar për periudhën 2020- 2023 është si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 28 pedagogë nga të cilët 26 PAE dhe 2 PAK (92% /8 %); 2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 28 pedagogë nga të cilët 26 PAE dhe 2 PAK (92% /8 %); 3. Për vitin akademik 2022 - 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 28 pedagogë nga të cilët 24 PAE dhe 4 PAK (85% / 15 %); 4. Për vitin akademik 2023 - 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 30 pedagogë nga të cilët 28 PAE dhe 2 PAK (93 % / 7 %); <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>5</td><td>1</td><td>5</td><td>1</td><td>6</td><td>2</td><td>7</td><td>1</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>12</td><td>-</td><td>12</td><td>-</td><td>9</td><td>1</td><td>12</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD.</td><td>8</td><td>1</td><td>8</td><td>1</td><td>9</td><td>1</td><td>9</td><td>1</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Totali</td><td>26</td><td>2</td><td>26</td><td>2</td><td>24</td><td>4</td><td>28</td><td>2</td></tr></table> Sipas RVB së, ky staf ka përvojë mësimore-formuese dhe përvojë klinike-profesionale diagnostikuese. Evidencë nr 65: Tabela e stafit akademik;	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	5	1	5	1	6	2	7	1	Prof. Asoc.	12	-	12	-	9	1	12	-	Dr/PhD.	8	1	8	1	9	1	9	1	Msc.	1	-	1	-	-	-	-	-	Totali	26	2	26	2	24	4	28	2
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		2023-2024																																																								
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																							
Prof.Dr.	5	1	5	1	6	2	7	1																																																							
Prof. Asoc.	12	-	12	-	9	1	12	-																																																							
Dr/PhD.	8	1	8	1	9	1	9	1																																																							
Msc.	1	-	1	-	-	-	-	-																																																							
Totali	26	2	26	2	24	4	28	2																																																							

Kriteri 2: Në çdo program specializues përcaktohen: Një figurë drejtuese, përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë pedagog me kohë të plotë në fushën përkatëse, të ketë të paktën titullin "Profesor i asociuar" dhe jo më pak se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Kjo figurë propozohet nga njësi baze përgjegjëse dhe miratohet në nivel të njësisë kryesore.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit të specializimit afatgjatë, programi i specializimit ka një Drejtues. Drejtuesi i programit të specializimit afatgjatë në Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, është emëruar Prof. M. D., me Dekret nr.5 datë 29.01.2019 të Rektorit. Prof. M. D ka titullin Profesor i Asociuar në fushën e Anestezisë dhe Reanimacionit në poliklinikën Tor Vergata, dhe ka më shumë se 10 vjet eksperiencë në fushën e Anestezisë dhe Reanimacionit. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë nr 39: Emërimi i drejtorit të programit të specializimit Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive</i>
Kriteri 3: Personeli akademik i programit të studimit specializim afatgjatë përbëhet nga: I. personel akademik me kohë të plotë me tituj akademikë dhe grada shkencore, jo më pak se 50% të pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Të paktën 1 (një) pedagog me kohë të plotë, i kategorisë profesor, duhet t'i përkasë fushës së programit të studimit. II. Personel akademik, i cili ushtron profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Ky personel akademik të ketë	Sipas tabelës nr.2 "Stafi akademik për programin e ciklit të studimit të ciklit të tretë specializim në Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, viti akademik 2023-2024, stafi akademik përbëhet: 1- 100% e stafit akademik me grada / tituj, nga ku 66.6 % i përkasin kategorisë "Profesor", dhe 33.4 % me gradë shkencore "DR". Një personel akademik me titullin "Profesor" është emëruar Drejtues i Programit të Specializimit Prof. M.D. 2- Personel akademik, sipas tabelës 2 dhe specializantët dhe struktura spitalore, të cilët ushtrorjnë profesionin në strukturat shëndetësore universitare të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi në masën jo më shumë se 50% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit. Ata kanë miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore ku punojnë. 3- Sipas tabelës nr.2 janë vetëm 2 pedagogë PAK që përbëjnë vetëm 7 % të stafit akademik. Programi ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", ku në bazë të marrëveshjes janë të angazhaur pedagogë të këtij universiteti. <i>Evidencë nr 65: Tabela e stafit akademik;</i> <i>Evidencë shtesë nr 1: Specializantët dhe strukturat spitalore.</i>

eksperiencë didaktike-formuese dhe eksperiencë profesionale-klinike diagnostike. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore të rrjetit formues kërkon miratimin paraprak të drejtuesit të strukturës shëndetësore. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës nga personeli i strukturave shëndetësore universitare, kërkon ne çdo rast miratimin paraprak nga IAL përkatëse, ku struktura shëndetësore universitare është pjesë përbërëse e saj. III. personel akademik me kohë të pjesshme, për disiplina të veçanta, jo më shumë se 10% e pedagogëve që mbulojnë programin e studimit, me të cilët lidhet një kontratë, sipas nevojave të strukturës së programit të studimit.	
Kriteri 4: Programi i studimit specializim afatgjatë ka drejtuesin/përgjegjës të programit. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit duhet të jetë personel akademik me kohë të plotë. Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit është njëkohësisht dhe anëtar i njësisë bazë përgjegjëse/shërbimit përgjegjës për programin e specializimit afatgjatë.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit të specializimit afatgjatë, programi i specializimit ka një Drejtues. Drejtuesi i programit të specializimit afatgjatë në Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, është emëruar Prof. M. D. me Dekret nr.5 datë 29.01.2019 të Rektorit. Prof. M. D ka titullin Profesor i Asociuar në fushën e Anestezisë dhe Reanimacionit në poliklinikë në Tor Vergata. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në M.jekësi;</i> <i>Evidencë nr 39: Emërimi i drejtorit të programit të specializimit Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive</i>

Përgjegjësi/drejtuesi i programit të specializimit zgjidhet nga anëtarët të asamblesë së njësisë bazë, me shumicë të thjeshtë (50%+1).

Përgjegjësi/drejtuesi i programit në një IAL nuk mund të ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të një tjetër programi studimi që realizohet nga IAL-të e tjera.

Kriteri 5: Njësia përgjegjëse garanton se ka kapacitete për udhëheqjen e specializantit.

Udhëheqësi i specializantit është: udhëheqës akademik dhe udhëheqës klinik diagnostik.

Numri maksimal i studentëve që mund të ndiqet nga udhëheqës akademik/klinik diagnostik është sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Drejtimi i specializantit i ngarkohet, në cilësinë e udhëheqësit, një pedagogu (udhëheqës akademik) dhe/ose një anëtar i personelit të strukturës shëndetësore të rrjetit formues (udhëheqës klinik/tutori) të programit të studimit, i cili/të cilët udhëheqin specializantin gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe janë përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e

Sipas tabelës 1.1 Departamenti i Shkencave Kirurgjikale ka kapacitete e nevojshme për udhëheqjen e specializantëve, ku në vitin akademik 2023-2024 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) (46 pedagogë PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) (27 pedagogë PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Shkencave Kirurgjikale	
	PAE	PAK
Prof.Dr	6	1
Prof.Asoc	12	5
Dr/PhD	25	11
SPA	3	-
Msc		10
Total	46	27
Gjithsej	73	

Programi ka 6 udhëheqës klinikë me grada / titujt akademikë përkatës: 5 janë të kategorisë "Profesor" dhe 1 Doktor i Shkencave. Sipas evidancave në programin e specializimit afatgjatë në Anestezilogji, Reanimacion dhe Terapi intensive janë 14 specializantë, të cilët udhëhiqen nga 6 udhëheqës klinikë. Sipas rregullores së studimit në SPA në Mjekësi, Neni 12, Specializanti ka një tutor (udhëheqës klinik) që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe është përgjegjës për orientimin, këshillimin dhe vlerësimin e nevojave të tij si edhe për monitorimin e punës së specializantit. Përvoja profesionale dhe klinike e udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit të

nevojave të studentit, si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e punës së studentit. Fusha e specializimit të udhëheqësit duhet të përputhet me atë të programit specializues që ndjek. Udhëheqësi klinik/tutori ka një experiencë profesionale të paktën 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) me përvojë klinike në fushën klinike përkatëse dhe ka të paktën gradën shkencare "Doktor". Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqet nga udhëheqësi akademik/klinik është 3 (tre). Udhëheqësi klinik/tutori është personel i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka kontratë bashkëpunimi me IAL-në që ofron programin. Kur tutori nuk është pjesë e personelit me kohë të plotë të strukturës që ofron programin e specializimit, specializantit i caktohet edhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik me kohë të plotë të institucionit. Për caktimin e udhëheqësit klinik merret vendimi i drejtuesit të	specializimit që ndjek specializanti. Numri maksimal i studentëve specializantë që mund të ndiqen nga një tutor është 3 (tre). Udhëheqësi (tutori) mund të punojë me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues si dhe duhet të ketë një kontratë bashkëpunimi me strukturën e lidhur gjatë kohëzgjatjes së programit të specializimit. Praktika klinike kryhet pranë qendrave spitalore në marrëveshje bashkëpunimi me UKZKM, si: QSUT "Nënë Tereza", Spitali Amerikan, Tor Vergata, Spitali M.G. Vaninni. Aktiviteti i mësimdhënies kryhet në ambjentet e UKZKM. <i>Evidencë nr 12: Rregullore e programit të studimit SPA në Mjekësi;</i> <i>Evidencë nr 65: Tabela e stafit akademik;</i> <i>Evidencë shtesë nr 1: Specializantët dhe strukturat spitalore.</i>
---	---

strukturës shëndetësore dhe udhëheqja e tij klinike konsiderohet si pjesë e orarit të punës. Aktiviteti i mësimdhënies kryhet njëkohësisht me aktivitetin asistencial/profesional, në përputhje me kërkesat e programit të studimit. Zhvillimi i aktivitetit mësimdhënës në sclinë ku realizohet programi i studimit nga personeli i strukturave shëndetësore universitare kërkon miratimin paraparak të drejtuesit të këtij shërbimi.									
Konkluzione	<i>Departamenti i Shkencave Kirurgjikale dhe Fakulteti i Mjeksisë kanë numrin e duhur të stafit akademik me titujt akademikë Profesorë dhe grada shkencore për të udhëhequr studentët në programin e studimit SPA në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive. Programi ka një drejtues të shkollës së specializimit të emëruar nga Rektori. Departamenti ka edhe stafin e duhur për mbikqyrjen e praktikës klinike.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><th>Niveli i përmbushjes</th><th>Përmbushet pjesërisht</th><th>Përmbushet kryesisht</th><th>Përmbushet plotësisht</th></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2

Institucioni garanton infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme në funksion të programit të specializimit afatgjatë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku	Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka një vendndodhje të përhershme që prej themelimit në vitin 2004, në Rrugën e Durrësit, për më shumë se 6 vjet.

zhvillohet veprimtaria mësimore. Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.	<i>Evidencë nr 1: VKM nr.567 datë 27.08.2004 "Për dhënien e hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike ZKM"</i>
Kriteri 2: Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).	Bazuar në vizitën në institucion si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione spitalore të akredituara dhe të nivelit terciar, UKZKM ka infrastrukturën e nevojshme dhe kapacitete teknologjike për të ofruar SPA në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive. UKZKM ka infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar programin mësimor (klasa për leksione dhe seminare) programe për zhvillimin e leksioneve on line, sidomos gjatë periudhës së pandemisë covid-19, librari për aksesimin e librave fizikë ose on-line. Universiteti ka marrë veshje bashkëpunimi me QSUT "Nënë Tereza", Spitalin Amerikan, Tor Vergata, të cilër kanë infrastrukturën e duhur për SPA në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive. UKZKM ka hapur vitet e fundit edhe spitalin e tyre, i cila ka edhe shërbimin e Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, por që janë proces akreditimi. <i>Evidencë nr 15-22: Lista e marrëveshjeve me institucionet spitalore;</i> <i>Evidencë: Vizitë në institucion.</i>
Kriteri 3: Institucioni disponon struktura shëndetësore të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike diagnostikuese, profesionale dhe didaktike. Akreditimi i këtyre strukturave bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.	Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione spitalore në vend, si: QSUT dhe në Itali, si poliklinika Tor Vergata, për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike diagnostikuese, profesionale dhe didaktike. QSUT është akredituar nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë së Shëndetit dhe Cështjeve Sociale për një periudhë 5 vjecare 2022-2027. <i>Evidencë nr 14: Marrëveshja midis UKZKM dhe QSUT Nënë Tereza;</i> <i>Evidencë nr. 68: Marrëveshja midis UKZKM dhe Fondacionit Leonardo;</i> <i>Evidencë nr 11: Link i akreditimit të spitaleve</i>

Kriteri 4: Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera, të njohura/akredituara sipas legjislacionit në fuqi.	Sipas Vendimit Nr.110 datë 10.11.2017 të Bordit të Akreditimit, programi i studimit specializues afatgjatë "Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive" ofrohet nga Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata". Universiteti i Romës "Tor Vergata" është i akredituar nga ANVUR (Agenzia Nazionale di Valutazione del Sistema Universitario e della Ricerca). <i>Evidencë nr 3; VKA 110 datë 10.11.2017; Evidencë nr 10 Linki ANVUR</i>			
Konkluzione	Universiteti Katolik ZKM ka në zotërim infrastrukturën e kërkuar për të ofruar aktivitete klinike dhe mësimore. UKZKM ka marrëveshje me institucione spitalore në Shqipëri dhe Itali me qëllim që të zhvillojë aktivitete klinike. Të gjitha institucionet që janë pjesë e ofrimit të programit të specializimit në Anesteziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive janë të akredituar sipas legjislacionit përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni, që ofron programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.	Programi i studimit të specializimit afatgjatë në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit nr.110 datë 10.11.2017, pika 1, thekson që programi i SPA plotëson kriteret ligjore dhe "Standartet e cilësisë" për SPA në fushën e Mjekësisë, në IAL. Programi i studimit SPA në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive ofrohet në gjuhën Italiane. <i>Evidencë nr 3: VKA 110 datë 10.11.2017</i>
Kriteri 2: Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënieje në gjuhë të huaj.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënieje në gjuhë italiane në programin e SPA në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive shumica dërrmuese janë italianë, dhe

huaj disponon një certifikatë për njohje të gjuhës së mësimdhënies të njohur ndërkombëtarisht, sipas kuadrit ligjor në fuqi.	pedagogët shqiptarë të angazhuar në këtë program zotërojnë gjuhën italiane. <i>Evidencë nr 65: Tabela e stafit akademik, tabela 2</i>			
Konkluzione	<i>UKZMK ofron programin e studimit të SPA në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata" në gjuhën Italiane, dhe ka stafin akademik të duhur i cili e ofron këtë program. Ky program është hapur bazuar në vendimin e Bordit të Akreditimit nr.11 datë 10.11.2017</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Strukturat qendrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe asistencial sipas kriterëve të mëposhtme dhe sipas kriterëve specifike të parashikuara në shtojcën 2: a. Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; b. Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara;	Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të mirë" ka marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave profesionale të specializimit afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive me institucione spitalore vendase dhe të huaja (Itali), si më poshtë: 1. QSUT "Nënë Tereza"; 2. Spitali Amerikan; 3. Spitali Rajonal i Durrësit; 4. Tor Vergata; 5. AST Manotva; 6. Spitali M.G. Vaninni UKZKM ka hapur dhe është në process akreditimi të spitalit universitar të tij, i cili përmban pavione me 38 shtretër, dhe një pavion të terapisë intensive. Institucionet shëndetësore spitalore të mësipërme kanë kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ si dhe sistencial: a. Kapaciteti infrastrukturor: kirurgji e përgjithshme dhe kirurgji e specializuar; Mjekësi interne dhe specialitete, pneumologji, kardiologji;

c. Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale; d. Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike.	b. Kapaciteti teknologjik: spitalet e kontraktuara nga UKZKM për specializimin afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive kanë pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara gjatë programit të studimeve, si: radiologji dhe diagnozë me imazhe, anatomi patologjike, laborator mjekësor diagnostikues; c. Kapaciteti organizativ: Strukturat spitalore kanë personelin e duhur mjekësor (anestezistë reanimatorë) dhe personel shëndetësor ndihmës (infermierë); d. Kapaciteti asistencial: nga vëzhgimi i raportit të vlerësimit nga Udhëheqësi klinik për aktivitete e kryera nga student Besnik Filaj si dhe studentët e tjerë, vërejmë që plotësohen kriteret assistenciale sipas Aneksit 2; <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje bashkëpunimi midis UKZKM dhe strukturave spitalore vendase dhe italiane; Evidencë nr 42: Vlerësimi i udhëheqësit klinik;</i>
Kriteri 2: Të gjitha strukturat (psh. Auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) Plotësojnë standardet e përgjithshme.	Bazuar në vizitën në institucion UNIZKM ka kampus me strukturat e duhuara për kryerjen e programit të studimit, si: auditorë, bibliotekë, sekretari mësimore, etj. Të gjitha strukturat plotësojnë standartet e nevojshme. Biblioteka "Paolo Ruatti" ka 18,000 tituj, dhe ofron kompjutera për bibliotekën elektronike, si dhe ofron databazet e mëposhtme për të gjetur literaturën e duhur: Hinary, JStore, Piattaforma. Biblioteka ka dhe faqen e saj zyrtare: https://biblioeb.unizkm.edu.al, e cila është e aksesueshme nga studentët dhe profesorët. Sekretaria është e vendosur në ambiente të përshtatshme për të ofruar shërbime ndaj studentëve sipas nevojës. <i>Evidencë : Vizita në institucion</i>
Kriteri 3: Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme: • sekretari didaktike • bibliotekë shkencore të pasur me botime dhe në formë elektronike	Bazuar në kërkesat e Aneksit 2 dhe evidentimit gjatë vizitës në institucion, vërejtëm se institucioni ka: sekretari mësimore, bibliotekën "Paolo Ruatti" me 18,000 tituj si dhe ofron kompjutera për librarinë elektronike, si dhe ofron për studentët platformat e mëposhtme: Hinary, JStore, Piattaforma; ka ambiente ambulatorie dhe spitalore të kontraktuara me shtretër (QSUT "Nënë Tereza, Spitali Amerikan, Spitali Rajonal Durrës, etj).

• Infrastruktura e plotë e IT-së. • laboratorë kërkimorë dhe didaktikë (nëse parashikohen në shtojcën nr.2) • ambulatorë dhe struktura asistenciale (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit) • ambiente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2) Ambjentet më sipër duhet të sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike dhe nuk kanë barriera arkitektonike që pengojnë aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.	<i>Evidencë : Vizita në institucion;</i> <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje bashkëpunimi midis UKZKM dhe strukturave spitalore vendase dhe italiane;</i>
Kriteri 4: Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifikë, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në: a. bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga	Specializimi afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive plotëson standardet e kërkuara sipas Aneksit 2, si më poshtë: a. QSUT "Nënë Tereza", Spitali Amerikan, Spitali Rajonal durrës, Tor Vergata, M.G. Vaninni, plotësojnë standardet bazë: strukturë me shtretër për reanimacion dhe terapi intensive; b. Standarte dytësore: toksikologji, terapi iperbarike c. shërbimet e përgjithshme: radiologji dhe diagnozë me iamzhe, anatomi patologjike, laborator mjekësor diagnostikues, kardiologji, neurologji, ndihmë e shpejtë e nivelit të parë e të dytë;

struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite. b. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qendrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat të tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi. c. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qendrore ose ajo dytësore që do të akreditohen.	UKZKM ka edhe spitalin e vetë i cili është në process akreditimi dhe plotëson disa standartet e kërkuara sipas Aneksit 2. <i>Evidencë : Vizita në institucion;</i> <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje bashkëpunimi midis UKZKM dhe strukturave spitalore vendase dhe italiane;</i>
Kriteri 5: Institucioni që ofron programet specializuese garanton se ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.	UKZKM në bashkëpunim me institucionet spitalore që ofrojnë specializimin afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive, ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara. <i>Evidencë : Vizita në institucion ;</i> <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje bashkëpunimi midis UKZKM dhe strukturave spitalore vendase dhe italiane;</i> <i>Evidencë nr 65; Tabela e stafit akademik</i>
Kriteri 6: Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën	UKZKM është i mirëorganizuar, duke përfshirë strukturat drejtuese: Rectori, Dekani, Senati si organ vendimmarrës, Fakultetet, Departamentet, si dhe disponon dokumentacion përkatës. <i>Evidencë: Vizita në institucion;</i>

drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.	<i>Evidencën 79: Tabela përmbledhëse;</i>			
Konkluzione	<i>UKZKM dhe institucionet spitalore që ofrojnë specializimin afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive plotësojnë standartet bazë, dytësore dhe shërbime të përgjithshme, shtrukturën e përshtatshme infrastrukturore, teknologjike dhe kapacitetet asistenciale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.5

Rrjeti formues plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.	Specializimi afatgjatë në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive ofrohet nga network institucionesh, që kryejnë aktivitetet teorike dhe praktik. Programi studimit specializimit afatgjatë ofrohet nga UKZKM në bashkëpunim me rrjet spitalesh: QSUT, Spitali Amerikan, Spitali Rajonal Durrës, Tor Vergata, etj, me të cilët UKZKM ka marrëveshje bashkëpunimi. Të gjithë spitalet plotësojnë kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në Aneksin 2. <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i>
Kriteri 2: Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.	Institucionet spitalore ku studentët kryejnë specializimin afatgjatë në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, është QSUT "Nënë Tereza", Spitali Amerikan, Spitali Rajonal Durrës, Tor Vergata, Spitali M.G. Vaninni, AST Mantova. Të gjithë institucionet plotësojnë kriteret e kërkuara sipas Aneksit 2, tabela 45, për standartet bazike, dytësore dhe shërbime të përgjithshme.

	<i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i>
Kriteri 3: Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kriterëve të mëposhtme: a. Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme b. Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional c. Burime financiare të mjaftueshme d. Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë e. Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale f. Programim i aktiviteteve orientuese, analizuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues g. Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve h. Efikasiteti dhe efienca në aktivitetet e ndryshme të parashikuara.	Rrjeti i institucioneve spitalore ku ofrohet programi i specializimit afatgjatë në Anestezilogji, Reanimacion dhe Terapi intensive, plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe specifike, të organizuara si më poshtë: 1. Ato kanë pajisjet dhe strukturat e përshtatshme për aktivitete mësimore dhe praktike në Anestezilogji, Reanimacion dhe Terapi intensive. Ato kanë specialitet të tillë në structure; 2. Ato performojnë numrin e mjaftueshëm të procedurave klinike për training profesional sipas Aneksit 2, tabelës 45, kriteret asistenciale; 3. UKZKM dhe strukturat spitalore pjesë e rrjetit që ofron SPA kanë burimet e duhura financiare me qëllim mbështetjen dhe ofrimin e aktiviteteve klinike; 4. Institucionet pjesë e rrjetit të ofrimit të SPA kanë stafin akademik e nevojshëm me gradat shkencore, të përshtatshëm për programin e specializimit; 5. Institucionet kanë pavione Anestezie dhe terapie intensive me stafin akademik dhe teknik të nevojshëm; 6. UKZKM ka kryer analizë të tregut në lidhje me nevojat për Anestezistë, dhe ka organizuar programin e specializimit afatgjatë bazuar në këtë studim; 7. UKZKM ka vendosur procedura bazuar në kornizën ligjore, me qëllim vlerësimin dhe zgjedhjen e studentëve; <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i> <i>Evidencë nr 34: Studimi i tregut në Anestezilogji, Reanimacion dhe Terapi intensive</i>
Kriteri 4: Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në	UKZKM disponon marrëveshjet me institucionet spitalore pjesë e rrjetit të ofrimit të specializimit afatgjatë në Anestezilogji, Reanimacion dhe Terapi intensive.

formimin specializues (qendrore/bazë).	<i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i>
Kriteri 5: Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të akredituara sipas legjislacionit në fuqi.	UKZKM dhe institucionet spitalore pjesë e rrjetit të ofrimit të specializimit afatgjatë në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive janë të akredituara sipas legjislacionit në fuqi në vendin përkatës. <i>Evidencë nr 10-11: Akreditimi i institucioneve pjesë e SPA; Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i>
Kriteri 6: Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.	UKZKM dhe institucionet spitalore pjesë e rrjetit të ofrimit të specializimit afatgjatë në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, kanë marrëveshje bashkëpunimi, ku janë të përshkruara ekzistenca e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve, të cilat janë në përputhje me standartet të kërkuara në Aneksin 2, tabelën 45. Ky fakt u pohua edhe nga studentët gjatë takimit me ata. <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i> <i>Evidencë : Takim me studentët</i>
Kriteri 7: Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve (sipas shtojcës 2).	UKZKM dhe institucionet spitalore pjesë e rrjetit të ofrimit të specializimit afatgjatë në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, kanë dokumentacionin e duhur që sqaron ekzistencën e specialitetit Anesteziologji dhe Reanimacion në strukturat e tyre. <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i>
Kriteri 8: Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin profesional të	UKZKM dhe institucionet spitalore pjesë e rrjetit të ofrimit të specializimit afatgjatë në Anestiziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive ofrojnë numrin e shërbimeve mjekësore të kërkuara në Aneksin 2, tabelën 45. Kjo shikohet edhe në raportin e Udhëheqësit klinik për studentin.



specializantëve (sipas shtojcës 2).	<i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i> <i>Evidencë nr 42: Vlerësimi udhëheqësit klinik</i>			
Kriteri 9: Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specializantët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2).	Bazuar në raportin e udhëheqësit klinik për studentin, aktiviteti asistencial i specializantit nuk e kalon 30% të aktivitetit të institucionit (QSUT, Spitali Amerikan, Tor Vergata). <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje institucionale midis UKZKM dhe spitaleve;</i> <i>Evidencë nr 42: Vlerësimi udhëheqësit klinik</i>			
Konkluzione	<i>Rrjeti i institucioneve të ofrimit të specializimit afatgjatë në Anestziologji, Reanimacion dhe Terapi intensive, është i përbërë nga institucionet mësimore dhe institucionet shëndetësore, si UKZKM, QSUT, Spitali Amerikan, Tor Vergata, etj që kanë lidhur marrëveshje bashkëpunim midis tyre. Të gjithë institucionet pjesë e rrjetit të trainimit plotësojnë kriteret minimale të parashikara në Aneksin 2, tabelën 45.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Njësa përgjegjëse për programin e specializimit afatgjatë dëshmon qëndrueshmëri finansiare dhe siguron mjetet e duhura të financimit dhe mbështetjes së studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni nëpërmjet raporteve dhe auditëve finansiare dëshmon ecure pozitive dhe qëndrueshmëri në	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me drejtuesit e e tij, deklaruan se institucioni e ka detyrim dhe përgatit raporte dhe auditë finansiare që dëshmon ecure positive dhe qëndrueshmërinë e tij. <u>Por, institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë të ndonjë raportit financiar apo auditues.</u>

gjenerimin dhe përdorimin e të ardhurave financiare.	
Kriteri 2: Njësia përgjegjëse siguron nëpërmjet institucionit, projekteve ose financimeve nga subjekte të tjera fondet e nevojshme për zhvillimin e programeve të specializimeve.	Bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me drejtuesit e institucionit, UKZKM bazohet në parimin e vetë-financimit, duke patur financime nga: Fondacioni "Zoja e Këshilit të Mirë", pagesat e studentëve, kërkimi shkencor dhe projekte, etj. Edhe Departamenti i Shkencave Kirurgjikale i siguron të ardhurat nga të njëjtat burime financiare. <u>Institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë që tregon të ardhurat e departamentit nga projekte të ndryshme.</u>
Kriteri 3: Programi i studimeve të specializimit afatgjatë mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm i njësise përgjegjëse.	Specializimi afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive mbështet nga buxheti i mjaftueshëm, dhe kjo u konfirmua nga takimi me stafin dhe studentët e programit të studimit. UKZKM në bashkëpunim me institucionet ku kryhet programi i studimit mbulon gjithë kostot e aktivitetit klinik. <i>Evidencë : Vizita në institucion;</i> <i>Evidencë nr 14-22: Marrëveshje bashkëpunimi midis UKZKM dhe strukturave spitalore vendase dhe italiane;</i>
Kriteri 4: Struktura e shpërndarjes së buxhetit financiar të programit të studimeve të specializimeve përputhet me politikën dhe zhvillimin e institucionit.	Alokimi i financave për programin e studimit të specializimit afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive bazohet në politikën e institucionit dhe kërkesat e ligjit, që ndahet sipas zërave: pagat, shpenzime operative, etj. <i>Evidencë : Vizita në institucion</i>
Kriteri 5: Përdorimi i mjeteve financiare të alokuara për zhvillimin e programit të specializimit është objekt i raportimit dhe auditimit të vazhdueshëm.	Sipas bisedës me drejtuesit e programit të studimit të specializimit afatgjatë në Anestezi, Reanimacion dhe Terapi intensive, përdorimi i fondeve në dispozicion të programit të specializimit është objekt i raportimeve dhe mbikqyrjes së vazhdueshme. <u>Institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë raport që tregon raportimet e kryera.</u> <i>Evidencë : Vizita në institucion</i>
Konkluzione	UKZKM ka performancë pozitive financiare, dhe këtë e ka treguar me qëndrueshmërinë e programeve të studimit të specializimit afatgjatë, si dhe mbështetja e kostove të trainimit në institucionet spitalore përkatëse. Por, institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë të ndonjë raportit financiar apo

	<i>auditues. Institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë evidencë që tregon të ardhura të departamentit nga projekte të ndryshme. Institucioni nuk ka dorëzuar ndonjë raport që tregon raportimet financiare të kryera.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. KËRKIMI DHE EKSPERIENCA KLINIKE /DIAGNOSTIKUESE

Standardi IV.1	
Specializanti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti ka një udhëheqës klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike diagnostike me gradën "Doktor".	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe intervistat e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konfirmon se institucioni përmbush këtë kriter të përcaktuar. Programi i studimit siguron udhëheqës klinik të kualifikuar dhe të specializuar në fushën përkatëse, me përvojë të dokumentuar mbi 10 vite në praktikat klinike diagnostikuese. Tutorët që marrin pjesë në këtë program mbajnë gradën akademike "Doktor". Ky informacion është konfirmuar përmes shqyrtimit të dosjeve individuale të stafit dhe vlerësimit të drejtpërdrejtë të praktikave të tyre profesionale. <i>Evidenca 12: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit të ciklit të tretë në Mjekësi;</i> <i>Evidenca 63: CV të stafit akademik;</i> <i>Evidenca 65: Tabelat e stafit akademik;</i>
Kriteri 2: Njësia bazë përgjegjëse/shërbimi përgjegjës përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën	Udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specialistëve, emërohen nga Këshilli Drejtues i programit të specializimit. Emërimi bëhet pas një rekomandimi pozitiv nga departamenti përkatës dhe Dekani i Fakultetit të Mjekësisë, duke u bazuar në një vlerësim të plotë

klinike e kërkimore të specializantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.	të arritjeve të tyre profesionale në fushën klinike dhe shkencore. (RVB f. 62)
Kriteri 3: Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin specializues.	Tutori është i punësuar me orar të plotë në bashkëpunim me strukturën e afiluar gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit të specializimit dhe ka një kontratë bashkëpunimi me ZKM. GVJ realizoi një shqyrtim të rastësishëm të një kontrate të tutorit brenda programit të specializimit, duke konfirmuar se të gjitha aspektet e kontratës janë në përputhje me standardet e kërkuara. <i>Takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore;</i> <i>Evidenca 50: Procesverbali i takimit për emërimin e mbikëqyrësve klinikë;</i>
Kriteri 4: Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.	GVJ konfirmon se institucioni ka ndërmarrë masa për të përmbushur këtë kriter. Udhëheqësit klinikë marrin pjesë rregullisht në aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, të mundësuar përmes marrëveshjeve formale me institucione akademike dhe klinike, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Këto marrëveshje ofrojnë mundësi për shkëmbimin e praktikave më të mira nëpërmjet programeve trajnuese, konferencave dhe punëtorive ndërkombëtare, duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave profesionale të mbikëqyrësve klinikë. <i>Evidencat 14-24: Marrëveshjet e bashkëpunimit me qendrat spitalore klinike në vend dhe në Itali;</i> <i>Takimi me rezidentët dhe stafin akademik;</i>
Kriteri 5: Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit në realizimin e studimeve specializuese dhe në	GVJ vlerëson udhëheqësit klinikë për ekspertizën e tyre, kualifikimet e duhura dhe gatishmërinë e tyre për të udhëhequr specializantët gjatë specializimeve dhe aspekteve praktike të programit. Ky vlerësim pozitiv është konfirmuar edhe përmes ndërveprimeve të drejtpërdrejta me disa prej mbikëqyrësve.

veçanti të pjesës praktike/klinike.	<i>Evidenca 63: Curriculum Vitae e Ligjëruesve; Takimi me stafin akademik dhe specialistët;</i>
Kriteri 6: Udhëheqësi klinik nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.	Sipas rregullores për studimet e specializimit, një tutor mund të mbikëqyrë deri në tre specialistë. Ky kriter zbatohet nga institucioni, duke pasur parasysh edhe numrin e kufizuar të specialistëve në program. Marrëveshja me institucionin rekomandohet nga vetë institucioni, dhe deri më tani nuk është paraqitur asnjë kërkesë për ndërrimin e tutorit. <i>Evidenca 41: Rregullorja për Studimet Afatgjata të Specializimit në Mjekësi; Takimi me Zyrën Sekretoriale;</i>
Kriteri 7: Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specialisti.	Fusha e specializimit të mbikëqyrësit klinik përputhet plotësisht me programin e specializimit. Dokumentet e fundit të përditësuar nga institucioni përfshijnë një listë të kandidatëve, tutorëve klinikë dhe strukturave spitalore ku zhvillohen programet e specializimit. Më shumë se gjysma e rezidentëve në Tor Vergata janë shtetas italianë. Megjithatë institucioni ofron mundësi për shkëmbime studentore, këto mundësi mbeten kryesisht të pashfrytëzuara nga mjekët vendas, kryesisht për shkak të kufizimeve financiare e familjare. Tor Vergata ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në ofrimin e mundësive kërkimore për specialistët. <i>Evidenca 65: Tabela e stafit akademik; Dokumentet shtese – Lista e specialistëve dhe strukturave spitalore;</i>
Kriteri 8: Në të gjitha rastet, studenti ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.	Studenti ka një mbikëqyrës primar përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të specializimit. Në rast të mungesës së mbikëqyrësit primar, studenti informohet për caktimin e një mbikëqyrësi zëvendësues. <i>Evidenca 12: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit në mjekësi në ZKM;</i>

Kriteri 9: Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin.	Institucioni ka ndërmarrë masa për të siguruar që mbikëqyrësit klinikë të kenë kohë të mjaftueshme për mbikëqyrjen efektive të specializantëve. Kjo është arritur përmes rregullimit të ngarkesës së punës së tyre, duke i dhënë përparësi mentorimit dhe mbikëqyrjes, ndërkohë që sigurohet një shpërndarje e balancuar midis detyrave mbikëqyrëse dhe atyre të tjera profesionale. <i>Takimi me stafin akademik; Evidenca 12: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit në mjekësi në ZKM;</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se institucioni i plotëson kriteret për mbikëqyrjen klinike në programin e specializimit. Mbikëqyrësit klinikë janë të kualifikuar, me mbi 10 vite përvojë në praktikat diagnostikuese dhe mbajnë gradën akademike "Doktor". Përzgjedhja e tyre bazohet në arritjet e tyre klinike dhe kërkimore, duke siguruar përputhshmërinë me programet e specializimit.</i> <i>Ata marrin pjesë rregullisht në zhvillimin profesional përmes bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Masat institucionale, për fshirë rregullimin e ngarkesës së punës dhe kufizimin e tre studenteve për çdo tutor, sigurojnë një mbikëqyrje efektive dhe cilësore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit.	GVJ konfirmon se institucioni angazhon aktivisht studentët në aktivitetet klinike dhe kërkimore. Programi siguron një balancë midis praktikës klinike dhe kërkimit shkencor, duke i integruar këto aspekte në kurrikulë dhe duke i mbështetur me infrastrukturën e nevojshme. Studentët marrin pjesë në projekte kërkimore të udhëhequra nga mentorë me përvojë, duke zhvilluar aftësi të avancuara që përmbushin kërkesat e programit dhe përgatiten për sfidat profesionale.

	<i>Evidenca 33: Prezantimi i programit të specializimit në Anestezi, Reanimacion dhe Kujdes Intensiv;</i> <i>Takimi me studentët;</i>
Kriteri 2: Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për: a. Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj; b. Punën e pavarur në laborator/klinikë; c. Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit; d. Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike; e. Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; f. Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializantit.	Që nga fillimi i specializimit, studentët angazhohen në programe teorike dhe praktike që përfshijnë përvetësimin e metodologjive për punë të pavarur, kryerjen e detyrave në laboratore dhe klinika, përdorimin e burimeve shkencore, aplikimin e teknologjive moderne të prezantimit dhe metodave analitike të avancuara. Studentët zhvillojnë aftësi në ofrimin e anestezisë së sigurt, teknika kirurgjikale dhe perioperative, menaxhimin e emergjencave, si dhe përdorimin e metodave të monitorimit invaziv dhe joinvaziv. Ata trajtojnë raste të terapive hiperbarike, menaxhojnë pacientë në gjendje kritike dhe respektojnë standardet bioetike dhe ligjore. Aktivitetet janë të strukturuar në fusha të tilla si mjekësia perioperative, reanimacioni dhe kujdesi emergjent. Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me studentët, GVJ vërejtë punën e tyre në një objekt modern, të pajisur me teknologjinë më të avancuar. <i>Takimi me studentët dhe stafin akademik;</i>
Kriteri 3: Studenti i programit specializues merr	Specializantët angazhohen në aktivitete që shkojnë përtej detyrave të tyre klinike, duke përfshirë ndjekjen e ligjëratave,

pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike. Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në: a. Ligjërata; b. Seminare; c. Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve; d. Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik. Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.	seminareve, tryezave të rrumbullakëta ndërdisiplinore, si dhe mundësi të tjera mësimore, si konferenca dhe seminare klinike. Ata marrin pjesë në këto aktivitete si pjesëmarrës ose si prezantues. Gjithashtu, studentëve u sigurohet mbështetje teknike e vazhdueshme për të lehtësuar aktivitetet e tyre klinike dhe kërkimore. <i>Takimi me studentët;</i> <i>Evidenca 71 – Certifikatat e konferencave;</i>
Kriteri 4: Studenti para diplomimit të tij, duhet të ketë botuar ose të pranuar të paktën një artikull kërkimor shkencor/eksperimental në një revistë shkencore brenda ose jashtë vendit, ku garantohej që niveli i ngjashmërisë artikullit të jetë nën 30%. Po ashtu ai duhet të ketë marrë pjesë në jo më pak se 2 aktivitete shkencore kombëtare	Studentëve të pranuar në programin e specializimit afatgjatë u sigurohen mjetet e nevojshme për të përfunduar me sukses studimet akademike dhe klinike. Atyre u ofrohet mbështetje teknike e vazhdueshme për të lehtësuar aktivitetet e tyre klinike dhe kërkimore. Universiteti ka dorëzuar certifikata si dëshmi të pjesëmarrjes në ngjarje shkencore të ndryshme. <i>Megjithatë, as RVB dhe as dokumentet mbështetëse nuk ofrojnë prova të mjaftueshme që vërtetojnë përmbushjen e këtij kriteri.</i> Staf i menaxhues ka identifikuar kërkimin shkencor si një nga sfidat kryesore të programit të specializimit, veçanërisht midis rezidentëve në Shqipëri.

dhe/ose ndërkombëtare në fushën përkatëse të specializimit.	<i>Evidenca 71 – Certifikatat e konferencave; RVB, fq. 63;</i>
Kriteri 5: Studenti fiton aftësi për komunikimin e duhur me nivel profesional.	GVJ konfirmon se institucioni garanton që studentët të zhvillojnë aftësi të avancuara në komunikimin profesional. Programi ofron trajnim dhe aktivitete praktike që ndihmojnë studentët të arrijnë qartësi, saktësi dhe respektimin e standardeve etike në komunikimin me pacientët, kolegët dhe mentorët. Këto aktivitete u ndihmojnë studentëve të përshtatin komunikimin e tyre në kontekste profesionale, duke siguruar një qasje efektive dhe të respektueshme në mjediset klinike. <i>Takimi me studentët dhe stafin akademik;</i>
Kriteri 6: Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët.	Institucioni plotëson kriterin për respektimin e standardeve etike dhe profesionale nga studentët. Studentët demonstrojnë sjellje etike dhe profesionale në raportet me pacientët, stafin akademik dhe kolegët, duke vepruar në përputhje me parimet e etikës mjekësore dhe duke zhvilluar aftësi për komunikim të qartë dhe efektiv. Institucioni ka vendosur procedura të qarta për trajtimin e shkeljeve disiplinore, të cilat zbatohen nga Universiteti, Urdhri i Mjekut dhe autoritetet përkatëse, duke siguruar përputhjen me standardet etike dhe krijimin e një mjedisi profesional të drejtë dhe të ndershëm. <i>Evidenca 24: Rregulloret e Fakultetit të Mjekësisë;</i> <i>Evidenca 33: Prezantimi i programit të specializimit në Anesteziologji, Reanimacion dhe Kujdes Intensiv;</i>
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se institucioni ofron një program specializimi të strukturuar mirë, me një kurrikul të balancuar, infrastrukturë moderne dhe mbështetje teknike të qëndrueshme. Studentët zhvillojnë aftësi klinike, kërkimore dhe komunikimi profesional, duke respektuar standardet etike.</i> <i>Megjithëse pjesëmarrja në ngjarje shkencore është e dokumentuar, sfida në fushën e kërkimit shkencor dhe</i>

¹Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikullimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegeve; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në klinikë, mbikqyrje ose demonstrime.

	<i>mungesa e disa provave mbështetëse kërkojnë vëmendje nga institucioni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTË T

Standardi V.1

Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacistë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues i nënshtrohet provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.	GVJ konfirmon se kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullore dhe shpalljen për programet e specializimit, si dhe që kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, mund të marrin pjesë në testin e pranimit. Procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes realizohet përmes një konkursi pranimi, duke përdorur një sistem vlerësim prej 100 pikësh. Sekretaria Akademike dhe Zyra e Statistikave luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe administrimin efikas të provimeve pranuese për programin e specializimit, duke garantuar transparencën dhe integritetin këtij procesi. Procesi i aplikimit për katër pozicione të disponueshme zakonisht tërheq aplikimin e 10-15 aplikantëve, të ndarë në mënyrë të barabartë midis kandidatëve shqiptarë dhe atyre italianë. <i>Evidenca 12: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi në ZKM; Takimi me Zyrën e Pranimeve;</i>
Kriteri 2: Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për	Institucioni përdor një sistem të kompjuterizuar dhe teknika të digjitalizimit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për specializim. Procesi i pranimit realizohet

përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).	përmes një provimi konkurrues me një total prej 100 pikësh, të ndarë si vijon: - 30 pikë për testin e njohurive të përgjithshme; - 40 pikë për testin e njohurive të specializuara; - 20 pikë për mesataren e ponderuar ose notën e diplomimit (në varësi të vendit të diplomimit); - 10 pikë për intervistën me gojë; Testi me shkrim përbëhet nga 60 pyetje me alternativa, të cilat duhet të plotësohen brenda 60 minutave. Komisioni vlerëson kualifikimet e dorëzuara dhe rezultatet e testeve, duke garantuar një proces të drejtë dhe transparent. <i>Takimi me stafin e Zyrës së Pranimeve;</i>
Kriteri 3: Institucioni shpall paraprakisht programin e parashikuar për provimin e pranimit dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.	Bazuar në dokumentet e ofruara dhe diskutimet me studentët dhe stafin administrativ, GVJ konfirmon se institucioni siguron komunikim transparent të programit dhe mjeteve të provimit pranues përpara provimit. Kjo qasje garanton që aplikantët të janë të mirëinformuar mbi metodat e vlerësimit që përdoren për të testuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e tyre. Kjo transparencë pasqyron përkushtimin e institucionit ndaj një procesi të drejtë vlerësimi dhe u mundëson kandidatëve të përgatiten në mënyrë adekuate. Zyra e Pranimeve ju ofron kandidatëve për programet e specializimit informacion të detajuar mbi procedurat e pranimit, kohëzgjatjen e programit, aktivitetet akademike dhe praktike të planifikuara, metodat e vlerësimit, kërkesat për diplomim dhe detaje të tjera të rëndësishme. Procedurat e pranimit në Universitetin KZKM publikohen çdo vit në faqen zyrtare të universitetit, www.unizkm.al, përmes njoftimeve të detajuara që përfshijnë pozicionet e disponueshme, kriteret e pranimit dhe informacione të tjera relevante.
Kriteri 4: Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.	Pas vizitës në institucion dhe vlerësimit të evidencave, GVJ konstaton se institucioni vazhdimisht rishikon dhe përmirëson politikat e pranimit për të mbështetur përparimin e studentëve në programin e studimit. Ky proces përfshin analizimin e performancës së studentëve, rishikimin periodik të kriterëve të pranimit dhe përshtatjen e tyre sipas nevojave të programit dhe rezultateve të arritura. Institucioni siguron që politikat e pranimit janë transparente, të drejta dhe promovojnë zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve.

	Renditja zyrtare publikohet në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM: www.unizkm.al , si dhe në Sekretarinë Akademike të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit Katolik ZKM, brenda afateve të përcaktuara në shpalljen e pranimi.			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni ka krijuar një proces transparent dhe efikas pranimi për këtë program specializimi. Kandidatët vlerësohen përmes një sistemi pikëzimi prej 100 pikësh, i cili përfshin teste, nota dhe intervista me gojë.</i> <i>I mbështetur nga Sekretaria Akademike dhe Zyra e Statistikave, sistemi i kompjuterizuar siguron drejtësi dhe barazi në procesin e pranimi.</i> <i>Institucioni informon kandidatët për procedurat dhe kërkesat e pranimi përmes faqes zyrtare dhe njoftimeve publike. Politikat e pranimi rishikohen rregullisht për t'u përshtatur me performancën e studentëve dhe kërkesat e programi. Renditjet zyrtare publikohen në faqen e internetit të universitetit dhe në Sekretarinë Akademike, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.	Sekretaria Akademike siguron informacion mbi numrin vjetor të specializantëve, si dhe mbi tërheqjet nga programi para përfundimit ose pamundësinë për të përfunduar vitin akademik. Sipas dokumenteve të siguruara, deri më tani nuk ka diplomuar asnjë specializant në këtë fushë. Gjatë tre viteve të fundit, pesë kandidatë janë regjistruar, prej të cilëve një është tërhequr nga programi i specializimit. <i>Evidenca 73: Tabela me numrin e specializantëve për çdo vit;</i>
Kriteri 2: Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që	Sekretaria ruan dokumentacion të detajuar për përparimin akademik të rezidentëve, duke përfshirë të dhënat e provimeve për çdo vit akademik, regjistrat e aktiviteteve praktike të kryera nga tutorët klinikë dhe të gjitha kualifikimet

nga pranimi (notate mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj).	dhe certifikatat përkatëse (si p.sh. punime shkencore të publikuara në revista të specializuara, pjesëmarrje të certifikuar në projekte kërkimore, kurse zhvillimi profesional dhe specializimi, kurse gjuhe, Master, PhD, etj).			
	Takimi me Sekretarinë:			
Konkluzione	Sekretaria Akademike ofron informacion thelbësor mbi numrin vjetor të specializantëve, tërheqjet nga programi dhe përparimin e tyre akademik. Gjatë tre viteve të fundit, pesë kandidatë janë regjistruar, prej të cilëve një është tërhequr nga programi. Përveç kësaj, Sekretaria ruan regjistra të detajuar mbi përparimin akademik të studentëve, duke përfshirë rezultatet e provimeve, regjistrat e aktiviteteve praktike dhe certifikatat përkatëse, si dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore dhe diploma të avancuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.	Studentët marrin informacion të detajuar mbi programin e specializimit, përfshirë procedurat e pranimi, kohëzgjatjen e programit, aktivitetet akademike dhe praktike të planifikuara, metodat e vlerësimit, kërkesat për diplomim dhe deta je të tjera përkatëse përmes faqes zyrtare të universitetit. Udhëzime shtesë janë të disponueshme edhe përmes koordinorit të programit. Kandidatët e kualifikuar duhet të dorëzojnë aplikimin dhe dokumentacionin e kërkuar në Sekretarinë Akademike. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, ata regjistrohen zyrtarisht dhe përzgjidhen për të marrë pjesë në aktivitetet teorike dhe klinike në institucionet shëndetësore të përfshira në bashkëpunim. Në fillim të programit, universiteti njofton kandidatët për mbikëqyrësin e caktuar, institucionin shëndetësor ku do të zhvillojnë aktivitetet praktike dhe strukturën e programit të specializimit. Nga takimi me studentët, ata u shprehën të kënaqur për kushtet e punës dhe

	bashkëpunimin me tutorët klinikë. Kërkesat e tyre janë pranuar dhe trajtuar me seriozitet nga stafi akademik dhe administrata.			
	<i>Takimi me studentët dhe Sekretarinë;</i>			
Kriteri 2: Studenti informohet nga njësia përgjegjëse për rezultatet e vlerësimit.	Departamenti përgjegjës për vlerësimin e rezultateve i komunikon ato te studentët. Vlerësimet e aftësive kryhen nga tutorët klinikë duke përdorur mjete të standardizuara dhe shqyrtohen nga Këshilli i Programit. Këto vlerësime konsolidohen në një raport vjetor, i cili miratohet nga Këshilli i Programit. Këshilli vendos nëse studentët kalojnë në vitin pasues ose kualifikohen për provimin përfundimtar. Dështimi për të kaluar mund të çojë në përsëritjen e vitit aktual, ndërsa dështimet e përsëritura rezultojnë në përjashtim nga programi. Rezultatet e vlerësimit komunikohen pas provimit, duke përfshirë qasjen përmes një portali të personalizuar për secilin specializant. <i>Evidenca 45: Renditja e konkursit të provimit pranues për specializimet asatgjata në M.jekësi;</i> <i>Evidenca 64: Procesverbali i Bordit Drejtues të Programit të Specializimit;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron transparencë në programin e specializimit duke ofruar informacion të detajuar mbi procedurat e pranimit, strukturën e programit dhe kërkesat përmes faqes zyrtare dhe koordinatorëve të programit. Kandidatët përfitojnë një proces formal regjistrimi, pas të cilit u caktohen mbikëqyrës dhe institucione klinike për kryerjen e aktiviteteve praktike. Një sistem vlerësimi rigoroz dhe i standardizuar, i mbikëqyrur nga Këshilli i Programit, përcakton përparimin e specializantëve ose kualifikimin e tyre për provimet përfundimtare. Rezultatet e vlerësimeve komunikohen në mënyrë transparente dhe efektive, duke përfshirë qasjen përmes një portali të personalizuar për secilin student.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik.	Pas vizitës në terren, GVJ konfirmon se institucioni ofron studentëve në programin e specializimit qasje në infrastrukturë moderne, përfshirë salla, laboratore, biblioteka, Njësi të Kujdesit Intensiv dhe hapësira të përbashkëta të përshtatura për nevojat e tyre. Investimet e vazhdueshme në teknologji të avancuar përmirësojnë cilësinë e mësimit dhe nxisin mundësitë kërkimore për studentët, specialistët dhe stafin akademik. Objektet janë të mirëmbajtura, të pastruara rregullisht dhe të dizajnuara për të mbështetur zhvillimin akademik, klinik dhe profesional të studentëve. <i>Evidenca 33: Prezantimi i programit të specializimit në Anestezi, Reanimacion dhe Kujdes Intensiv;</i>
Kriteri 2: Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike/diagnostike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.	Programi i specializimit integron objektivat e studentëve në fushat klinike, diagnostike dhe kërkimore. Ai thekson zhvillimin e balancuar të aftësive praktike dhe kërkimit shkencor, duke i pajisur studentët me kompetencat e nevojshme për karrierë profesionale dhe mundësi punësimi. Ky strukturim i përgatit ata për të përmbushur kërkesat e tregut të punës dhe për ngritje profesionale. Gjatë takimit me studentët, u theksua se ZKM ofron një bazë të fortë në njohuritë teorike, të plotësuara nga trajnimi praktik që ofrohet në QSUT dhe qendrat e tjera spitalore që trajtojnë një numër të madh pacientësh. Nga takimi me specializantë, ata e konsideruan të rëndësishëm përmirësimin e dokumentimit të punës dhe përvojës praktike në spitale. <i>Takimi me studentët dhe stafin akademik;</i>
Kriteri 3: Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.	Institucioni plotëson këtë kriter duke ofruar studentëve të këtij specializimi qasje në një bibliotekë të pasur. Kjo bibliotekë ka një koleksion prej mbi 19,000 titujsh, botime që përditësohen rregullisht në forma të shtypura dhe digjitale, dhe një infrastrukturë të plotë të Teknologjisë së Informacionit, duke mbështetur në mënyrë efikase nevojat akademike dhe kërkimore të studentëve dhe pedagogëve.



	<i>Evidenca 69: Lista e librave; Vizita në bibliotekë; Takimi me studentët;</i>
Kriteri 4: Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.	Zyra e IT ofron mbështetje të plotë për studentët duke disponuar tre stacione PC në bibliotekë për qasje në platformat dhe abonimet online, si dhe tre dhoma të pajisura me kompjuterë, të gjitha me software të licencuar dhe qasje në internet për burimet online. Studentët dhe pedagogët mund të aksesojnë portale si Jstor dhe Himnari duke përdorur llogari personale (@stud.unizkm.al për studentët dhe @prof.unizkm.al për pedagogët), të cilat mund të përdoren në çdo pajisje, brenda dhe jashtë rrjetit të institucionit. Spitalet sigurojnë mbështetje të mjaftueshme për realizimin e punës praktike klinike.
Kriteri 5: Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.	Informacioni në lidhje me këtë komponent nuk është i pranishëm në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm ose në dokumentacionin e dorëzuar.
Kriteri 6: Studenti është i siguruar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.	Gjatë gjithë periudhës së programit të specializimit, studentët janë të siguruar për të gjitha aktivitetet e planifikuara. Pas regjistrimit, ata marrin një kopje të polisës së sigurimit, e cila mbulon përgjegjësinë profesionale për dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta, si dhe dëmet e pësura gjatë periudhës së specializimit dhe kryerjes së detyrave të parashikuara në program. Fakulteti mbulon kostot e polisës së sigurimit, e cila paguhet drejtpërdrejt tek Kompania e Sigurimeve. <i>Evidenca 57: Polisa e Sigurimit; Takimi me studentët;</i>
Kriteri 7: Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit.	Referuar RVB-së, Zyra e Orientimit të Karrierës në ZKM mban një bazë të dhënash për të diplomuarit, sipas së cilës 96% e tyre janë të punësuar, ndërsa 4% janë të papunë. Grupi i papunë përbëhet kryesisht nga të diplomuar të rinj që presin provimin shtetëror ose ata që po ndjekin studime të mëtejshme, si një Master, dhe po fokusohen në arsimin e tyre. Aktualisht, nuk ka të diplomuar në Anestezi, Reanimacion dhe Kujdes Intensiv, kështu që të dhënat pasqyrojnë të diplomuarit në nivel institucional. <i>Takimi me Zyrën e Orientimit të Karrierës;</i>

Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se institucioni ofron studentëve në programin e specializimit qasje në objekte moderne, përfshirë klasa, laboratore, biblioteka, Njësi të Kujdesit Intensiv dhe hapësira të përbashkëta. Investimet në teknologji përmirësojnë mundësitë për arsimin dhe kërkimin, të mbështetura nga një bibliotekë e pajisur me mbi 19,000 tituj dhe burime të plota të TI.</i> <i>Studentët janë të siguruar gjatë gjithë programit për aktivitetet akademike dhe klinike, duke garantuar mbrojtjen e tyre. Aktualisht, nuk ka të diplomuar në programin Anestezie, Reanimacion dhe Kujdes Intensiv. Megjithatë, pavarësisht këtyre avantazheve, RVB dhe dokumentacioni i siguruar nuk ofrojnë informacion të detajuar mbi angazhimin e specializantëve në kërkime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në regulloren e specializimit.	Referuar RVB, në fund të çdo viti akademik, zhvillohet provimi teorik dhe praktik, i cili vlerësohet me notë përfundimtare. Drejtori dhe Koordinatori i programit përcaktojnë datën, formatin dhe materialet për provimin. Komisioni prej pesë anëtarësh vlerëson provimin dhe komunikon rezultatet si verbalisht ashtu edhe me shkrim. Nëse studenti dështon pesë here në provim, atëherë merr një certifikatë për modulet e përfunduara dhe kreditet dhe ndërpret studimet. Rezultatet e suksesshme regjistrohen dhe publikohen në portalin personal të studentëve. Mbikëqyrësit klinikë përgatisin raporte të rregullta mbi aktivitetet praktike, të cilat ruhen në dosjet e studentëve. Për të marrë pjesë në provimin përfundimtar, studentët duhet të kenë përmbushur të gjitha detyrimet vjetore dhe të kenë miratimin e dosjeve të tyre nga Këshilli i Specializimit.

	<i>Evidenca 12: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi në UZKM, 2023;</i> <i>Evidenca 42: Vlerësimi i tutorëve klinikë; Takimi me stafin dhe studentët;</i>
Kriteri 2: Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.	UNIZKM ofron mjete teknologjike të avancuara për vlerësimin e njohurive të studentëve. Këto përfshijnë një lexues optik për provime me alternativa me shumë zgjedhje deri në 60 pyetje, duke garantuar anonimitetin dhe vlerësim automatik përmes barkodeve; platformën Exam Online për provime të shkruara me pyetje të hapura ose me shumë zgjedhje, e cila ka mbikëqyrje audio dhe video në modin "Safe Exam Browser"; Google Meet dhe Microsoft Teams për zhvillimin e provimeve me gojë në distancë ose në formatet hibride; dhe një dhomë për videokonferenca me universitete partnere, e cila është e përshtatur posaçërisht për provimet me gojë. <i>Evidenca 61: Tabela e të dhënave të platformës online; Takimi me studentët dhe stafin akademik;</i>
Kriteri 3: Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.	Përfundimet e vlerësimeve të vazhdueshme janë të përcaktuara qartë dhe komunikohen në mënyrë transparente të studentët, duke trajtuar vendimet për pezullim, zgjatje ose përjashtim nga studimet e specializimit. Procesi i provimeve për vlerësimin e studentëve është transparent dhe i organizuar mirë. Roli aktiv i Komisionit siguron një vlerësim të besueshëm, ndërsa komunikimi i qartë i rezultateve, si verbalisht ashtu edhe me shkrim, përmirëson transparencën e procesit. Mundësia për të marrë një certifikatë për modulet e përfunduara pas disa tentativave tregon një qasje korrekte që vlerëson përpjekjet e studentëve. <i>Takimi me studentët dhe menaxhmentin;</i>
Kriteri 4: Vlerësimi i studentëve bëhet sipas lëndëve që ka ndjekur specializanti gjatë atij viti akademik.	Vlerësimi i studentëve është i organizuar në mënyrë sistematike dhe i dokumentuar në mënyrë të detajuar. Mentorët klinikë përgatisin raporte të hollësishme mbi punën praktike të studentëve, të cilat përfshihen në dosjet e tyre akademike për një vlerësim të plotë. Programi kërkon përmbushjen e kushteve vjetore dhe miratimin nga Këshilli i Specializimit. Vetëm studentët që plotësojnë këto kriterë mund të marrin pjesë në provimin përfundimtar.

	<i>Evidenca 12: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit në Mjekësi në UZKM, 2023;</i> <i>Takimi me studentët;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka një sistem vlerësimi transparent dhe të besueshëm për specializantët, i cili kombinon provime vjetore teorike dhe praktike me komunikim të qartë të rezultateve. Mjetet teknologjike të avancuara rrisin efikasitetin dhe transparencën e procesit. Mentorët klinikë dokumentojnë punën praktike të studentëve, e cila vlerësohet në mënyrë sistematike. Studentët duhet të përmbushin kërkesat vjetore dhe të marrin miratimin nga Këshilli i Specializimit për të marrë pjesë në provimin përfundimtar. Ky proces siguron korrektësi, përgjegjshmëri dhe një vlerësim gjithëpërfshirës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN E SPECIALIZIMIT AFATGJATË

Standardi VI.1	
Institucioni dhe njësisë përgjegjëse lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të specializimit afatgjatë, në kundërshtim të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni mban standarde të larta përmes politikave dhe procedurave të strukturuar mirë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), të cilat janë në përputhje me udhëzimet ligjore dhe institucionale, duke përmbushur në mënyrë efektive kriteret kyçe të cilësisë arsimore. Që nga viti 2004-2005, UNIZKM ka adoptuar metodat e sigurimit të cilësisë të përdorura nga universitetet e tij partnere italiane që ofrojnë programe të ngjashme.

	<i>Evidenca 7: Emërimi i Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 75: Emërimi i Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë;</i>
Kriteri 2: Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në përputhje me Nenin 103 të Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Shqipëri dhe Nenin 22 të Statutit të Universitetit, është krijuar zyrtarisht Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi operon sipas një Rregulloreje të veçantë dhe ka qasje periodike në të gjitha aktet, dokumentet dhe informacionet që lidhen me universitetin, duke siguruar konfidencialitetin e të dhënave të mbledhura. Metoda kryesore e vlerësimit, e menaxhuar nga zyra përkatëse, përfshin vlerësimet e studentëve. <i>Evidenca 23: Statuti i Universitetit;</i>
Kriteri 3: Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni tregon një qasje proaktive ndaj sigurimit të cilësisë, duke përdorur proceset e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë në arsimin e lartë të ofruara nga ASCAL. Këto përfshijnë vlerësime të akreditimit të jashtëm, vlerësime analitike dhe krahasuese, si dhe metoda të tjera që synojnë përmirësimin e cilësisë. Kjo qasje reflekton angazhimin e institucionit për vanasim në segmentin arsimor dhe përputhshmërinë me rregulloret e miratuara shtetërore. <i>Evidenca 24: Rregullorja e Fakultetit të Mjekësisë; Takimi me grupin e vlerësimit të brendshëm;</i>
Kriteri 4: Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësisve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Përmes NjSBC, institucioni synon të zhvillojë dhe promovojë një kulturë cilësie në të gjitha nivelet institucionale, duke përfshirë njësitë përbërëse dhe palët e brendshme të interesuara. Organizimi dhe funksionimi i kësaj njësie janë përcaktuar qartë dhe në mënyrë të plotë në Rregullore. <i>Evidenca 7: Emërimi i Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 24: Rregullorja e Fakultetit të Mjekësisë;</i>
Konkluzione	<i>Institucioni tregon një angazhim për avansimin arsimor përmes proceseve të strukturuar mirë të sigurimit të</i>

	<i>brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Kjo është bërë duke krijuar NjSBC, e cila është në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe statutin e universitetit, për të mbikëqyrur menaxhimin e cilësisë dhe për të siguruar konfidencialitetin. Duke adoptuar praktikën e sigurimit të cilësisë nga universiteti partner italian dhe duke përdorur akreditimet dhe vlerësimet analitike të ASCAL, institucioni mundëson përmirësim të vazhdueshëm institucional e programor, përfshirë këtë program specializimi. NjSBC promovon një kulturë cilësie në të gjitha nivelet e institucionit, duke siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe përputhshmëri me standardet e larta arsimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni dhe njësia përgjegjëse monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të specializimit.	GVJ konfirmon se institucioni ka krijuar njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të specializimit, duke krijuar një njësi të veçantë të dedikuar për këto aktivitete- Njësia e Vlerësimit të Brendshme të Cilësisë. <i>Evidenca 75: Emërimi i Njesisë së Vlerësimit të Cilësisë;</i>
Kriteri 2: Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të specializimit.	Institucioni përdor metoda të dokumentuara dhe formale për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e programit të specializimit. Zyra e Statistikave mbledh dhe menaxhon të dhëna mbi perceptimet e studentëve për kurset e tyre përmes anketave anonime, duke mbuluar aspekte strukturore, didaktike dhe administrative në nivelin e programit dhe të kurseve. Studentëve u ofrohet gjithashtu mundësia për të dhënë reagime të hapura, ndërsa të dhënat e mbledhura përpunohen dhe futen në një bazë të dhënash për programin e specializimit dhe mësuesit. <i>Evidenca 76: Modeli i pyetësorit;</i> <i>Takimi me studentët;</i>

Kriteri 3: Institucioni ka përcaktuar indikatorë dhe tregues cilësorë të matshëm sasiorë për programin e specializimit në kudër të vlerësimit të cilësisë së programit.	Indikatorët dhe metrikat cilësore të matshme për vlerësimin e cilësisë së programit të specializimit përfshijnë performancën akademike dhe praktike të specializantëve, duke u fokusuar në rezultatet e provimeve, kreditet e grumbulluara dhe arritjen e objektivave të programit që lidhen me aftësitë teknike dhe profesionale. Vlerësimi gjithashtu merr parasysh pjesëmarrjen në aktivitete klinike dhe diagnostike nën mbikëqyrjen e mentorëve klinikë, cilësinë dhe kapacitetin e objekteve mbështetëse të spitaleve dhe universiteteve, si dhe numrin dhe kompleksitetin e rasteve klinike të menaxhuara gjatë periudhës së specializimit. <i>Evidenca 78: Perceptimi i specializantëve;</i>
Kriteri 4: Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Për të përmbushur këtë kriter, institucioni përdor metoda dhe mjete të strukturuar mirë për vlerësimin dhe matjen e zbatimit efektiv të programit të specializimit. Këto përfshijnë vlerësime periodike të performancës akademike dhe praktike të specializantëve përmes provimeve teorike dhe praktike, si dhe raporte vjetore nga mentorët klinikë që detajojnë përparimin dhe aktivitetet praktike të studentëve. Institucioni gjithashtu realizon anketa dhe analiza statistike për të identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim. Mekanizmat e monitorimit vlerësojnë cilësinë e strukturave mbështetëse, kurse metodologjitë përditësohen në bazë të rezultateve të analizave. <i>Evidenca 75: Emërimi i Njësisë së Vlerësimit të Cilësisë;</i>
Kriteri 5: Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Pas mbledhjes së të dhënave nga njësitë akademike dhe administrative, si dhe nga Zyra e Statistikave, Njësia përgatit një raport vjetor për Rektorin dhe Senatin Akademik. Ky raport përfshin aktivitetet mësimore, shërbimet universitare, si dhe funksionalitetin dhe efikasitetin e arritur përgjithësisht. Njësia gjithashtu ofron vlerësime dhe formulon rekomandime për Rektorin dhe Senatin në lidhje me objektivat, nivelin e arritjes së tyre dhe masat e nevojshme për të adresuar sfidat dhe për të përmirësuar cilësinë. <i>Evidenca 77: Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Njësisë;</i> <i>Takimi me menaxhmentin;</i>
Kriteri 6: Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e	Për të përmbushur këtë kriter, raportet e vlerësimit ofrojnë një përshkrim të qartë të rezultateve të pritshme të programit. Ato identifikojnë mangësitë dhe përshkruajnë masat specifike që

prishme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	janë marrë për t'i adresuar ato. Raportet përfaqësojnë rekomandime të detajuara për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke përcaktuar një plan veprimi, afate kohore dhe përgjegjësi të caktuara për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe përmirësimin e qëndrueshëm të programit. <i>Takimi me grupin e sigurimit të cilësisë;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni tregon angazhimin e tij për sigurimin e cilësisë përmes NJSBC, e cila mbikëqyr monitorimin dhe vlerësimin e programit. E mbështetur nga Zyra e Statistikave, vlerësimet përfshijnë anketa dhe reagime mbi performancën akademike dhe praktike, duke u fokusuar në tregues siç janë: rezultatet e provimeve, kreditet, pjesëmarrja klinike dhe cilësinë e objekteve. Vlerësime periodike, raporte nga mentorët dhe analiza identifikojnë fushat që kërkojnë përmirësim dhe metodologjitë përditësohen përkatësisht. Raportet vjetore për Rektorin dhe Senatin ofrojnë rekomandime të veprueshme, duke siguruar përputhshmërinë me standardet dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VL3

Institucioni dhe njësi përgjegjëse përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Vlerësimi i brendshëm i programit të specializimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, apo	Institucioni përmbush këtë kriter përmes një procesi të brendshëm të rishikimit sistematik, të udhëhequr nga NJSBC, duke qenë në përputhje me procedurat e vetëvlerësimit të institucioneve dhe kornizën e akreditimit. Anketat elektronike vjetore u mundësojnë specializantëve të vlerësojnë stafin akademik dhe administrativ, me 86% të pjesëmarrësve në Programin e Specializimit në Anestezi, Reanimacion dhe terapi intensive që kanë dhënë një vlerësim mesatar prej 6.8 pikë nga maksimumi 7 pikë. <i>Evidenca 78: Perceptimi i specializantëve;</i>

vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	
Kriteri 2: Për kryerjen e vlerësimit, Institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën që ka programi i specializimit.	GVJ konfirmon se, në përputhje me rregulloret e tij dhe natyrën specifike të programit të specializimit, institucioni përdor një gamë metodash dhe mjetes të specializuara. Duke mbledhur informacion dhe duke bashkëpunuar me entitete të ndryshme organizative dhe kërkimore brenda Universitetit, UZKM realizon aktivitetet në mënyrë efikase, duke siguruar një vlerësim sistematik të programit dhe duke ruajtur cilësinë dhe integritetin. Për realizimin e aktiviteteve, njësia përdor një sërë mjetes, përfshirë metoda direkte dhe indirekte për mbledhjen e informacionit. <i>Evidenca 41: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit në mjekësi, 2019;</i> <i>Evidenca 42: Vlerësimi i tutorit klinik; Takimi me menaxhmentin;</i>
Kriteri 3: Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë.	Institucioni përdor metoda direkte për vlerësimin e cilësisë në rishikimet e programeve, duke përfshirë intervista të strukturuar dhe kërkesa për informacion, të cilat shpesh komunikohen përmes email-it. Ky hap fillestar mbledh të dhëna thelbësore dhe, kur është e nevojshme, pason me intervista joformale për të sqaruar ose thelluar më tej tema kyçe. Duke kombinuar qasje formale dhe joformale, institucioni siguron një kuptim të plotë të çështjeve kritike dhe adreson mangësitë informuese. Po ashtu, reagimet nga specialistët mbledhen përmes takimeve me Koordinatorin e Programit. <i>Evidenca 78: Perceptimi i specialistëve;</i>
Kriteri 4: Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, të personelit akademik, udhëheqësve dhe partnerëve.	Institucioni përdor metoda të tërthorta të vlerësimit, si anketa dhe intervista, për të mbledhur reagime nga studentët, të diplomuarit e programeve të tjera, stafi akademik, mentorët dhe partnerët. Komentet dhe sygjerimet e studentëve mbledhen përmes takimeve midis specialistëve dhe Koordinatorit të Programit. Këto ndërveprime luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin në kohë reale të procesit arsimor dhe ofrojnë informacion të vlefshëm mbi cilësinë e mësimdhënies dhe shërbimeve administrative. <i>Evidenca 41: Rregullorja për studimet afatgjata të specializimit në mjekësi, 2019;</i>

Kriteri 5: Mekanizmat e vlerësimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit, përfshijnë palët e interesuara, institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Institucioni angazhon aktivisht palët e interesuara, partnerët dhe grupe të tjera relevante në proceset e tij të vlerësimit. Koordinator monitoron efektivitetin e programit dhe kënaqshmërinë e studentëve me programin. Rezultatet tregojnë se stafi dhe studentët janë të kënaqur me programin. <i>Evidenca 78: Perceptimi i specialistëve;</i> <i>Takimi me studentët;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni përmbush kriterin e sigurimit të cilësisë përmes një procesi të brendshëm të rishikimit sistematik, të menaxhuar nga njësi e sigurimit të cilësisë. Ky proces është në përputhje me kornizën e vetëvlerësimit dhe akreditimit. Specialistët ofrojnë fedback vjetor me vlerësime të larta kënaqshmërisë, me një mesatare prej 6.8 nga 7. Institucioni përdor metoda direkte dhe indirekte, përfshirë anketa, intervista dhe takime me Koordinatorin e Programit, duke siguruar monitorim në kohë reale. Palët e interesuara dhe koordinatori kontribuojnë në vlerësimin e efektivitetit të programit dhe kënaqësisë, duke reflektuar miratimin e fortë për stafin mësimor dhe rezultatet e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VL4

Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe	Institucioni siguron angazhimin aktiv të hisedarëve të brendshëm dhe të jashtëm. Sipas Nenit 15 të Statutit, Rectori emëron anëtarët e NjSBC. Kjo njësi e monitoron menaxhimin dhe aktivitetet e Universitetit për të siguruar arritjen e objektivave, duke ofruar mbështetje për organet e universitetit


të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit.	dhe duke kontribuar në përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të cilësisë institucionale. <i>Evidenca 7: Emërimi i Komisionit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë;</i> <i>Evidenca 23: Statuti i Universitetit;</i>
Kriteri 2: Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni përcakton rolet dhe përgjegjësitë specifike të njësive, individëve, studentëve dhe palëve të tjera të interesuara që janë të përfshirë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së të programit të studimit. Për të siguruar standarde të larta cilësie në aktivitetet e universitetit, NjSBC harton dhe shpërndan anketa për studentët dhe stafin akademik, propozon përmirësime në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbime për studentët, dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara nga rregulloret ose organet drejtuese të Universitetit, duke siguruar përparimin e vazhdueshëm të cilësisë institucionale. <i>Evidenca 12: Rregullorja për Studimet Afatgjata të Specializimit në Mjekësi në UZKM, 2023;</i>
Kriteri 3: Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës-akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit, institucioni konfirmon pjesëmarrjen aktive të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, përfshirë stafin akademik, ndihmësit akademikë dhe administrativë, si dhe studentët. <i>Takimi me menaxhmentin dhe grupin e vlerësimit të brendshëm;</i>
Kriteri 4: Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konfirmon se institucioni angazhon aktivisht aktorët e brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke ruajtur integritetin akademik dhe siguruar barazi, duke shmangur çdo formë diskriminimi ndaj stafit dhe studentëve. <i>Evidenca 24: Rregullorja e Fakultetit të Mjekësisë;</i>
Kriteri 5: Pjesë aktive e procceseve të vlerësimit dhe	Gjatë vizitës në terren, GVJ u informua nga stafi se institucioni përmbush këtë kriter duke i angazhuar ata aktivisht në proceset

sigurimit të brendshëm të cilësisë, mund të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	e rishikimit të brendshëm dhe sigurimit të cilësisë, ku ekspertiza e tyre kontribuon në mënyrë të rëndësishme në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit. Megjithatë, ky aktivitet nuk u gjet në RVB. <i>Takimi me menaxhmentin;</i>			
Kriteri 6: Monitorimi i ecurisë akademike e programit dhe sigurimi i cilësisë, është pjesë e veprimtarisë së njësive përgjegjëse që ofron programin dhe NJSBC.	Monitorimi i përparimit akademik dhe sigurimi i cilësisë janë komponenta thelbësore të aktiviteteve që kryhen nga njësia përgjegjëse për ofrimin e programit dhe NJSBC. Këto struktura bashkëpunojnë për të ruajtur cilësinë dhe për të siguruar përputhshmërinë me standardet akademike të programit. Të gjithë pjesëmarrësit në programin e specializimit, përfshirë studentët, stafin administrativ dhe tutorët, kontribuojnë në menaxhimin dhe zhvillimin e programit. Ata marrin pjesë aktivisht në konsultime dhe takime të rregullta, duke adresuar dhe zgjidhur sfidat gjatë procesit të mësimin, me qëllimin e përbashkët për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e përgjithshme të programit të studimit. <i>Evidenca 75: Emërimi i Njësive të Vlerësimit të Cilësisë;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni mundëson sigurimin e cilësisë duke angazhuar palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme në vlerësimin e programit. NJSBC, e emëruar nga Rektori, mbikëqyr aktivitetet e universitetit, monitoron përparimin akademik dhe siguron përputhshmërinë me standardet. Ajo kryen anketa, propozon përmirësime dhe nxit avancimin institucional. Palët e interesuara të brendshme adresojnë sfidat përmes konsultimeve, ndërsa ekspertët e jashtëm kontribuojnë në sigurimin e cilësisë gjatë vizitave në terren.</i>			
Shtalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VL5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1: Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni promovon aktivisht transparencën në sistemin e tij të sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke siguruar që studentët dhe palët e interesuara të kenë qasje në informacion të përditësuar dhe të plotë. Kjo qasje nxit besimin, mundëson identifikimin e çështjeve kritike dhe thekson mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm. Në përputhje me Statutin dhe Rregulloret, NjSBC përgatit një raport vjetor për Rektoren dhe Senatin Akademik. Raporti vlerëson aktivitetet e mësimeve, kërkimit shkencor dhe shërbimet universitare, duke analizuar gjithashtu funksionalitetin dhe efikasitetin e strukturave organizative, si dhe planifikimin për vitin që vjen. <i>Evidenca 23: Statuti i Universitetit;</i> <i>Evidenca 75: Emërimi i Njësive të Vlerësimit të Cilësisë;</i>
Kriteri 2: Institucioni dhe njësia përgjegjëse publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni tregon angazhimin e tij për integritetin dhe transparencën duke publikuar përgjegjësisht rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit në faqen e tij zyrtare. Kjo praktikë përputhet me standardet etike, respekton lirinë akademike dhe është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. NjSBC përfundon raportin e saj me rekomandime, të mbështetura nga një analizë SWOT të përmbledhur, dhe ia dorëzon raportin vjetor Rektorit dhe Senatit Akademik. <i>Evidenca 24: Rregullorja e Fakultetit të Mjekësisë;</i> <i>Evidenca 23: Statuti i Universitetit;</i>
Kriteri 3: Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në RVB përmendet se rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan veprimi që trajton mangësitë dhe dobësitë e identifikuar, me qëllimin për të përmirësuar cilësinë dhe për të përmbushur standardet e vendosura. Po ashtu, theksohet se ky plan ofron një komizë të strukturuar për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve dhe performancës institucionale. Megjithatë, në dokumentacionin e ofruar nuk është i disponueshëm një plan veprimi i veçantë.



	RV.B.f.7.81;			
Kriteri 4: Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UZKM vlerëson dhe siguron ndikimin e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Këto aktivitete janë të rëndësishme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, duke siguruar përputhshmërinë me standardet akademike dhe arritjen e objektivave të programit. RV.B.f.7.81;			
Kriteri 5: Institucioni dhe njësi përgjegjëse organizon veprimtari periodike me personelin akademik përgjegjëse dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit.	Institucioni, në partneritet me njësinë përgjegjëse, organizon aktivitete të rregullta për stafin dhe studentët për të promovuar ndërgjegjësimin dhe kuptimin e përpjekjeve të vazhdueshme për sigurimin e cilësisë. <i>Evidenca 77: Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Njësive;</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron transparencë dhe integritet në proceset e tij të sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes raporteve vjetore të njësive, të cilat përfshijnë analiza SWOT dhe rekomandime përcjellëse, duke siguruar vlerësim sistematik dhe përmirësim të vazhdueshëm. Rezultatet e vlerësimit janë në përputhje me standardet etike dhe ligjet për mbrojtjen e të dhënave. Këto përpjekje, të shoqëruara me plane veprimi, mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në bashkëpunim me njësinë e përgjegjëse, institucioni angazhon stafin dhe studentët në aktivitete të rregullta për të promovuar ndërgjegjësimin mbi sigurimin e cilësisë, duke ruajtur standardet akademike të larta dhe duke nxitur përmirësimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk është përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundimetë Vlerësimit të programit të studimit Ciklit të Tretë Specializime Afatgjatë në "Anesteziologji, reanimacion dhe terapi intensive"

a. Pika të forta dhe afirmime:


1. Institucioni ofron mjedise dhe infrastrukturë moderne të teknologjisë së informacionit (Njësi të Kujdesit Intensiv të pajisura mirë, salla mësimi, laboratore dhe bibliotekë me mbi 19,000 tituj);
2. Mentorët klinikë janë profesionistë me mbi 10 vjet përvojë, duke siguruar trajnim të cilësisë së lartë për specializantët;
3. Studentët janë të siguruar gjatë gjithë programit për aktivitetet akademike dhe klinike;
4. Procesi i pranimit është konkurrues dhe i dokumentuar mirë, duke siguruar drejtësi dhe përputhshmëri me standardet akademike;
5. Metodatat e vlerësimit përfshijnë provime teorike dhe praktike, të mbështetura nga mjete teknologjike të avancuara;
6. Institucioni ka një Njësi të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të strukturuar mirë, e cila mbikëqyr vlerësimin e programit, kryen anketa dhe siguron përputhshmërinë me standardet akademike;

b. Pika të dobëta:

1. Raporti midis orëve teorike dhe veprimtarive klinike/diagnostikuese nuk është në përputhje me rregulloren e programit të specializimit afatgjatë; (*Standarti II.2, kriteri 4*);
2. Mungesa e evidencës që tregon të ardhura të departamentit nga projekte të ndryshme, si dhe mungesa e raportit financiar; (*Standarti III.6 kriteri 2*)
3. Dëshmia për përfshirjen e specializantëve në aktivitete kërkimore është e pamjaftueshme dhe kërkimi është identifikuar si një sfidë në program; (*Standarti IV.2 kriteri 4*)

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të rishikojë raportin midis orëve teorike dhe veprimtarive klinike/diagnostikuese, sipas rregullores së programit të specializimit afatgjatë;
2. Institucioni duhet të përgatisë raport që tregon të ardhura të departamentit nga projekte të ndryshme si dhe raportimet financiare të kryera;
3. Të rritet përfshirja e specializantëve në projektet kërkimore;
4. Të ofrohet mbështetje financiare përmes granteve dhe bursave për të inkurajuar specializantët vendorë që të kryejnë pjesë të specializimit në Itali;
5. Të përfshihet Siguria e Pacientit në kurrikulën e programit specialistik;



Evaluation's conclusions for the Long-Term Specialization Study Program in "Anesthesia, Resuscitation, and Intensive Care"

a. Strengths and affirmations:

1. The institution provides state-of-the-art IT facilities and infrastructure, including well-equipped Intensive Care Units, modern classrooms, laboratories, and a library with over 19,000 titles;
2. Clinical mentors are qualified professionals with over 10 years of experience, offering high level training for residents;
3. Students are covered by insurance throughout the program for both academic and clinical activities;
4. The admission process is rigorous, transparent, and well-documented, ensuring fairness and adherence to academic standards;
5. Assessment methods incorporate both theoretical and practical examinations, supported by advanced technological tools;
6. The institution has a well-structured Internal Quality Assurance Unit, which monitors program evaluation, conducts regular surveys, and ensures compliance with academic standards;

b. Weaknesses:

1. Ratio between theoretical hours and clinical/diagnostic practice is not in accordance with long term specialization regulation; (*Standard II.2, criteria 4*)
2. There is insufficient evidence which prove department incomes from different projects, and lack of financial reports as well; (*Standard III.6 criteria 2*)
3. There is insufficient evidence of residents' participation in research activities, and research has been identified by institution's stakeholders as a challenge within the program; (*Standard IV, criteria 4*)

Recommendations:

1. Institution must review ratio between theoretical hours and clinical/diagnostic practice hours, in accordance with long term specialization regulation;
2. Institution must prepare department income report from projects and financial reports as well;
3. Enhance the participation of residents in research projects;
4. Offer financial support through grants and scholarships to motivate local residents to complete a part of their specialization in Italy;
5. Integrate Patient Safety into the curriculum of the specialization program;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. KUADRII PËRGJITHSHËM I PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË				X
II. ORGANIZIMI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT				X
III. BURIMET NË FUNKSION TË PROGRAMIT SPECIALIZIM AFATGJATË				X
IV. KËRKIMI DHE EKSPERIENCA KLINIKE /DIAGNOSTIKUESE				X
V. STUDENTËT				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË NË PROGRAMIN SPECIALIZIMIT AFATGJATË				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X